



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 136

Tiranë – E premte, 31 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 51, datë 20.7.2015	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm..... 9745
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 52, datë 20.7.2015	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 286, datë 8.02.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. 641, datë 16.11.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë, brenda një afati të arsyeshëm. Dëmshpërblimi i dëmit të ardhur nga mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë..... 9749
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 53, datë 20.7.2015	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2012-2695 (532), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë..... 9754
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 54, datë 20.7.2015	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-3595, datë 12.12.2014 të Gjykatës së Lartë..... 9758
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 55, datë 21.7.2015	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të togfjalëshit “dhe në doza të vogla”, në paragrafin e parë të nenit 283 të Kodit Penal..... 9762
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 56, datë 21.7.2015	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm..... 9772

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 23.7.2015	Me objekt: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt (jo më pak se një e katërta e deputetëve). Deklarimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 36, datë 22.05.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e një komisioni hetimor për verifikimin e fakteve dhe të rrethanave të bëra publike për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët””, si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.....	9779
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 58, datë 23.7.2015	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2013-2413, datë 17.02.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	9787
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 23.7.2015	Me objekt shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-2166, datë 24.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	9792



VENDIM
Nr. 51, datë 20.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	”
Sokol Berberi	anëtar i	“	”
Vitore Tusha	anëtare e	“	”
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	”
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	”
Gani Dizdari	anëtar i	“	”
Besnik Imeraj	anëtar i	“	”
Fatos Lulo	anëtar i	“	”

me sekretare Edmira Babaj, në datën 12.03.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 11 Akti, që i përket:

KËRKUES: Sokol Hasani

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarisi ka ushtruar funksionin e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t deri në datën 07.03.2012 kur është liruar nga kjo detyrë me urdhrin nr. 31 të Kryeministrit. Urdhri i lirimit është ankimuar nga kërkuarisi pranë Këshillit të Ministrave, por nuk ka marrë përgjigje brenda afatit të përcaktuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

2. Në këto kushte kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke depozituar në datën 02.05.2012 kërkesë-padinë me objekt: *“Detyrimin e palës së paditur për të shpërblyer paditësin me pagën e 12 muajve për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, pagën e 1 muaji për mosrespektim afati dhe të 2 muajve për mosrespektim të afatit të zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe pavlefshmërinë e urdhrin të lirimit.”*

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10006, datë 24.10.2012, ka vendosur kthimin e kërkesë-padisë dhe të akteve të tjera si padi me të meta për shkak të mospagimit të taksës gjyqësore në shumën 12.000 lekë. Kërkuarisi, duke pretenduar se për konfliktet që lindin nga marrëdhëniet e punës nuk ka tarifë, ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit, e cila, me vendimin nr. 302, datë 20.06.2013, ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit në atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

4. Kërkuarisi, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, në seancën gjyqësore të datës 10.02.2014 ka paraqitur kërkesë për shpalljen e moskompetencës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Kjo kërkesë u pranua me vendimin nr. 1916, datë 10.02.2014 dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

5. Në vijim kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dy herë duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Për të dyja kërkesat e paraqitura prej tij është vendosur moskalimi i çështjes në seancë plenare, respektivisht me vendimet nr. 108, datë 20.05.2014 dhe nr. 157, datë 19.09.2014.

II

6. **Kërkuarisi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për herë të tretë duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata e



Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka marrë masat e nevojshme që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt, për t'i siguruar progresit të gjykimit shpejtësi të mjaftueshme. Ndonëse mosmarrëveshjet për shkak të marrëdhënieve të punës duhet të trajtohen me procedurë të përsheptuar, në rastin konkret veprimet procedurale të kryera nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të tilla si kthimi i padisë për plotësimin e të metave, mosrespektimi i kërkesave të KPC-së për njoftimin e seancës gjyqësore, shtyrja e seancave gjyqësore për arsye të mungesës së palës së paditur pa shkak të arsyeshëm ose për shkak të miratimit nga Gjykata e Lartë të vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013, ankimet ose rekursat e paraqitura pas datës 04.11.2013 dhe mosdeklarimi i mungesës së kompetencës, kanë shkaktuar zvarritje të procesit gjyqësor, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenet 6/1 e 13 të KEDNJ-së. Kërkuesi pretendon se çështja e tij po zgjat rreth 3 vjet dhe ka tendencë zvarritjeje të mëtejshme të procesit, për sa kohë çështja vazhdon të shtyhet edhe në gjykatën administrative ku ka kaluar për kompetencë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se në bazë të neneve 131, shkronja "P", dhe 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme. Gjykata ka pranuar se kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të tyre ende nuk ka përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 12, datë 05.03.2012; nr. 35 datë 17.07.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se sistemi juridik i vendit nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë, të cilin kërkuesi mund ta përdorte për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit

gjyqësor. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga GJEDNJ-ja në vendimin e datës 23.10.2007, Gjonbocari kundër Shqipërisë, apl. nr. 10508/02, § 77, në të cilin është shprehur se duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se Qeveria pranoi se sistemi juridik shqiptar nuk parashikonte një mjet të veçantë juridik, të cilin aplikanti mund ta përdorte për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimin Marini kundër Shqipërisë, datë 7.7.2008, apl. nr. 3738/02, § 154, edhe në vendimin Hamzaraj kundër Shqipërisë, datë 3.2.2009, § 30, apl. nr. 45264/04, në të cilët shprehet se Gjykata rikujton vendimin e saj të datës 23.10.2007, Gjonbocari kundër Shqipërisë, apl. nr. 10508/02, § 77, ku ka konstatuar se në sistemin e brendshëm juridik nuk ka pasur mjete juridike efektive lidhur me tejzgjatjen e procesit, për pasojë aplikanti shkarkohet nga shterimi i mjeteve të brendshme (*shih vendimin nr. 12 datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* t'i drejtohet Gjykatës për kërkimet e tij edhe pse shqyrtimi i çështjes në fjalë nuk është mbyllur në të gjitha shkallët e juridiksionit të zakonshëm gjyqësor.

B. Për themelin

8. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregull ligjor si rezultat i moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të nenit 42/2 të Kushtetutës.

9. Gjykata rithekson se karakteri i arsyeshëm i kohëzgjatjes së një procedure vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes dhe sipas kriterëve të konsoliduara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, që janë: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit dhe e autoriteteve kompetente, si dhe rreziku që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimet nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 21, datë 03.06.2011; nr. 21 datë 07.04.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata konstaton se çështja në shqyrtim është paraqitur për herë të tretë përpara saj dhe se më parë kërkesa me të njëjtin objekt dhe për të njëjtën çështje i është nënshtruar vlerësimit paraprak në Kolegjin e Gjyqtarëve Kushtetues (*Kolegji*) (*shih vendimet nr. 108, datë 20.05.2014; nr.*



157, datë 19.09.2014 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese). Sipas materialeve të dosjes dhe të dhënave të administruara në vendimet e Kolegjit, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka konstatuar disa të meta të padisë, ka caktuar datën 24.10.2012 për të verifikuar plotësimin e tyre. Si rezultat i mosplotësimit të tyre, gjyqtari i vetëm ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë dhe të akteve të tjera si padi me të meta. Në datën 29.10.2012 kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit, e cila ka zhvilluar seancën e parë në datën 04.04.2013, duke vendosur shtyrjen për shkak të mungesës së paditësit, që ishte i angazhuar jashtë vendit. Seanca e datës 14.05.2013 nuk është zhvilluar, pasi paditësi ka paraqitur raport mjekësor. Seanca e datës 23.04.2013 është shtyrë, pasi paditësi nuk ka marrë dijeni sipas fletëthirrjes. Seanca e datës 06.06.2013 është shtyrë, pasi pala e paditur ka qenë në mungesë dhe paditësi e ka lënë në çmimin e gjykatës vijimin e procesit gjyqësor. Në seancën e datës 20.06.2013 Gjykata e Apelit ka marrë vendimin gjyqësor duke e kthyer çështjen për vazhdimin e gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Çështja është reregjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 26.09.2013, kurse vendimi për shpalljen e moskompetencës lëndore është i datës 10.02.2014. Në këtë periudhë janë zhvilluar tri seanca gjyqësore (19.11.2013 – veprimet përgatitore, 20.12.2013 – pala paditëse kërkon të njoftohet edhe një herë pala e paditur, 10.02.2014 - vendimi për shpallje moskompetence). Në datën 07.03.2014 çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, kurse shorti për caktimin e gjyqtarit relator është hedhur në datën 10.03.2014. Në procesverbalin e veprimeve përgatitore të datës 11.03.2014 është caktuar seanca e parë përgatitore në datën 10.04.2014, por ajo është shtyrë për shkak të mosnjoftimit të palës paditëse (*kërkuesi*), si rrjedhojë e adresës së shënuar gabim në aktin e njoftimit. Seanca e radhës është caktuar në datën 26.05.2014, por kjo seancë është shtyrë për në datën 14.07.2014 për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarës në një trajnim. Kjo seancë është shtyrë me kërkesë për saktësimin e ndërgjyqësisë nga kërkuesi dhe seanca e radhës është caktuar në datën 21.10.2014.

11. Gjykata vëren se një pjesë e shkaqeve të shtyrjes së këtyre seancave u referohen kërkesave që burojnë nga Kodi i Procedurës Civile në lidhje me rregullsinë e kërkesëpadisë dhe plotësimin e të metave të saj, kurse pjesa tjetër janë rrjedhojë e mosparaqitjes së kërkuetit në gjykim për arsye shëndetësore ose të tjera.

12. Gjykata, pasi vlerësoi rrethanat e mësipërme të çështjes, elementet e parashtruara nga kërkuesi dhe informacionet e marra nga gjykatat e zakonshme lidhur me ecurinë e këtij gjykimi, konsideron se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente të cilat mund të çonin në një konkluzion të ndryshëm nga sa është konstatuar në vendimet e Kolegjit nr. 108, datë 20.05.2014 dhe nr. 157, datë 19.09.2014. Për më tepër, pas vendimit më të fundit të Kolegjit, që i përket datës 19.09.2014, deri në datën 03.11.2014, kur kërkesa është paraqitur për herë të tretë përpara Gjykatës, rezulton të jetë shtyrë vetëm një seancë gjyqësore për shkak se gjyqtarja ka qenë me leje, e konfirmuar kjo edhe me vendimin nr. 604 prot., datë 14.10.2014 të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Si rrjedhim, Gjykata çmon se në rastin konkret pretendimi i kërkuetit për kohëzgjatje të procedurës gjyqësore në tejkallim të afatit të arsyeshëm është i pabazuar.

13. Në përfundim, Gjykata nuk konstaton cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.



Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

Lidhur me përfundimin e arritur në çështjen me kërkuar Sokol Hasanin nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën, prandaj e çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

Shumica ka konkluduar se kërkuar nuk i është cenuar e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, i parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

Në vlerësimin tonë, kërkuar i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektin e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se lidhur me tejzgjatjen e procesit gjyqësor ajo mbështetet në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, të reflektuara më pas edhe në praktikën e saj. Sipas këtyre kriterëve, arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuar, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që sjell për kërkuar kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjatë gjykimit ka rezultuar se kërkesëpadia është depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 02.05.2012. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ka konstatuar disa të meta të padisë, ka caktuar datën 24.10.2012 për të verifikuar plotësimin e tyre. Si rezultat i mosplotësimit të tyre gjyqtari i vetëm ka vendosur kthimin e kërkesëpadisë dhe të akteve të tjera. Në datën 29.10.2012 kërkuar ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila ka zhvilluar seancën e parë në datën 04.04.2013, duke vendosur shtyrjen për shkak të mungesës së paditësit, pasi ndodhej jashtë vendit. Seancat në vijim jashtë shtyrë për arsye të ndryshme, konkretisht: Seanca e datës 14.05.2013 nuk është zhvilluar, pasi paditësi ka paraqitur

raport mjekësor; seanca e datës 23.04.2013 është shtyrë pasi paditësi nuk ka marrë dënim sipas fletëthirrjes, seanca e datës 06.06.2013 është shtyrë, pasi pala e paditur ka qenë në mungesë dhe paditësi e ka lënë në çmimin e gjykatës vijimin e procesit gjyqësor. Në seancën e datës 20.06.2013 Gjykata e Apelit Tiranë ka marrë vendim duke e kthyer çështjen për vazhdimin e gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 26.09.2013, kurse vendimi për shpalljen e moskompetencës lëndore është i datës 10.02.2014. Në këtë periudhë kohore janë zhvilluar tri seanca gjyqësore, si vijojnë: në seancën e datës 19.11.2013 janë kryer veprimet përgatitore, në seancën e datës 20.12.2013 pala paditëse ka kërkuar të njoftohet përsëri pala e paditur dhe në seancën e datës 10.02.2014 gjykata ka marrë vendim për shpallje të moskompetencës. Në datën 07.03.2014 çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kurse shorti për caktimin e gjyqtarit relator është hedhur në datën 10.03.2014. Sipas procesverbalit të datës 11.03.2014 seanca e parë përgatitore është caktuar në datën 10.04.2014, por ajo është shtyrë për shkak të mosnjoftimit të palës paditëse (*kërkuar*), si rrjedhojë e adresës së shënuar gabim në aktin e njoftimit. Seanca e radhës është caktuar në datën 26.05.2014, por kjo seancë është shtyrë për në datën 14.07.2014 për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarës në një trajnim. Kjo seancë është shtyrë për saktësimin e ndërgjyqësisë nga kërkuar dhe seanca e radhës është caktuar në datën 21.10.2014. Edhe kjo seancë (veprime përgatitore) është shtyrë për shkak të lejes 4-ditore të gjyqtarës, bazuar në vendimin përkatës të Kryetarit të Gjykatës. Seanca e radhës është zhvilluar në datën 27.11.2014, në të cilën është caktuar seanca gjyqësore në datë 10.12.2014. Në seancën gjyqësore të datës 10.12.2014 gjykata ka marrë vendim duke rrëzuar kërkesëpadinë e paraqitur nga kërkuar.

Kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese edhe dy herë të tjera duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Për këto dy kërkesa Kolegjet e



Gjykatës Kushtetuese kanë vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, konkretisht me vendimet nr. 108, datë 20.05.2014 dhe nr. 157, datë 19.09.2014. Pas shqyrtimit të kërkesës nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese, janë zhvilluar edhe disa seanca të tjera gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë, ku rezulton se nga data 11.03.2014 deri në datën 27.11.2014 janë zhvilluar rreth 6 seanca për veprimet përgatitore. Hapësira kohore nga një seancë tek tjetra shkon nga një muaj deri në tre muaj.

Bazuar në llojin e mosmarrëveshjes në gjykim, si dhe në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, arrihet në përfundimin se është cenuar parimi i zhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Nisur nga rrethanat e mësipërme dhe deri në momentin e paraqitjes së kërkesës objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, kur nuk ka një vendim themeli në lidhje me pretendimin e kërkuarit, periudha e shqyrtimit të çështjes duhej të konsiderohej kohë e tejzgjatur lidhur me procesin gjyqësor.

Për sa i përket kompleksitetit, gjykimi i iniciuar prej kërkuarit ka për objekt detyrimin për të shlyer kërkuarësin me pagën e 12 muajve për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, me pagën e 1 muaji për mosrespektim të afatit dhe të 2 muajve për mosrespektim të afatit të zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe pavlefshmërinë e urdhrit të lirim. Nisur nga natyra e këtij gjykimi, nuk paraqitet me natyrë komplekse dhe nuk justifikon zgjatjen e procesit gjyqësor.

Për sa i përket sjelljes së kërkuarit, ai nuk ka shkaktuar vonesa të pajustificuara për zhvillimin gjyqësor. Në vlerësimin tonë shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë të lidhura me përmbushjen dhe ushtrimin e të drejtave të tij procedurale. Në këtë drejtim, përdorimi nga ana e tij i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimet nr. 9, datë 1.04.2009; nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e

sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë për detyrë të sigurojnë të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces që të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen artikullimin e saj edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilave: “*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor...*”¹ dhe “*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj*”².

Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmojmë se kërkuarësi Sokol Hasani i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha

VENDIM

Nr. 52, datë 20.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	”
Sokol Berberi	anëtar i	“	”
Vitore Tusha	anëtare e	“	”
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	”
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	”
Gani Dizdari	anëtar i	“	”
Besnik Imeraj	anëtar i	“	”
Fatos Lulo	anëtar i	“	”

me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 14.04.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 21 Akti, që i përket:

¹ Neni 4 i Kodit të Procedurës Civile.

² Neni 171, shkronja “a”, i Kodit të Procedurës Civile.



KËRKUES: Hamdi Bajramaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, Zyra Përmbartimore Tiranë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 286, datë 08.02.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, lënë në fuqi me vendimin nr. 641, datë 16.11.2007 të Gjykatës së Apelit Vlorë, brenda një afati të arsyeshëm. Dëshmëpërblimi i dëmit të ardhur nga mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2. 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Hamdi Bajramaj ka mbajtur pozicionin përgjegjës i Policisë Tatimore Vlorë nga data 03.05.2006 deri në datën 18.09.2006. Me vendimin nr. 1460, datë 18.09.2006 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i është dhënë masa disiplinore “Ndërprerje e marrëdhënieve të punës”. Kërkuari, duke mos qenë dakord me këtë vendim, i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi për konstatimin e pavlefshmërisë së këtij vendimi dhe rregullimin e pasojave të ardhura prej tij.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 286, datë 08.02.2007, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e padisë, si dhe deklarimin

e pavlefshmërisë së vendimit nr. 1460, datë 18.09.2006, duke detyruar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Degën e Tatimeve Vlorë që të dëshmëpërblejnë paditësin Hamdi Bajramaj me 12 paga dëshmëpërblim dhe ta kthejnë atë në punën e mëparshme.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 641, datë 16.11.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit *supra* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ky vendim është korrigjuar me vendimin nr. 18, datë 20.05.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

4. Kundër këtyre vendimeve nuk është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe me vendimin nr. 630, datë 12.09.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin gjyqësor nr. 286, datë 08.02.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5. Kërkuari i është drejtuar disa herë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për ekzekutimin e vendimit, por prej tyre nuk ka marrë përgjigje. Në vijim i është drejtuar Zyrës Përmbartimore Tiranë për ekzekutimin e këtij vendimi.

6. Zyra Përmbartimore Tiranë, me shkresën nr. 9643, datë 25.06.2009, ka kërkuar ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Në vijim ka marrë vendimin e datës 12.11.2009 për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, i cili i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nëpërmjet shkresës nr. 17468, prot., datë 12.11.2009.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. 5355/1, datë 21.04.2010, ka kërkuar plotësimin e dokumentacionit të praktikës përmbartimore. Në vijim kërkuari ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (vitet 2010-2011) nga ku është sqaruar nëpërmjet shkresave nr. 12780/1, datë 05.09.2010, nr. 12780/3, datë 17.11.2010 dhe nr. 7018/1, datë 14.04.2011 se praktika e tij është përcjellë për ekzekutim pranë strukturave përgjegjëse dhe është konfirmuar likuidimi i pjesshëm i vendimit gjyqësor, ndërsa për rikthimin në vendin e tij të mëparshëm të punës, për shkak të ristrukturimit rezultonte se Sektori i Policisë Tatimore ishte suprimuar.

8. Zyra Përmbartimore Tiranë ka vijuar me një sërë veprimesh në harkun kohor 2012-2014, si:



vënien e sekuestros konservative në zërin 602 “shpenzime operative” të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, njoftimin për përlllogaritje të pagës, ekzekutimin e vendimit gjyqësor edhe për pjesën e rikthimit në punë etj.

9. Në datën 17.07.2014, me shkresën nr. 18681/1 prot., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka njoftuar kërkuesin se ky institucion e ka ekzekutuar pjesërisht vendimin gjyqësor, duke kryer vetëm likuidimin e detyrimit monetar ndaj tij.

II

10. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 05.02.2014, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, duke kërkuar edhe shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror. Kërkuesi pretendon se shkak i cenimit të së drejtës është sjellja e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me mosekzekutimin e detyrimit për rikthimin në punë në vendin që ka mbajtur deri në momentin e largimit padrejtësisht nga puna. Gjithashtu, ai ka kërkuar pagimin e diferencave të pagave të papaguara.

11. **Subjekti i interesuar**, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në pretendimet me shkrim para Gjykatës ka prapësuar:

11.1 Pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, është i pabazuar për sa kohë detyrimi monetar përkundrejt kërkuesit është ekzekutuar tërësisht.

11.2 Vendimi gjyqësor i formës së prerë për pjesën e rikthimit në punë, edhe pse nuk është ankimuar me rekurs në Gjykatën e Lartë (GJL), është haptazi i paligjshëm dhe bie ndesh me praktikën njehsuese të Kolegjeve të Bashkuara të GJL-së (*shih vendimet nr. 31, datë 14.04.2003, nr. 19, datë 15.1.2007; nr. 7, datë 01.06.2011 të Kolegjeve të Bashkuara*), ku përcaktohet se e drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore absolute.

12. **Subjekti i interesuar**, Zyra Përmbarimore Tiranë, me anë të shkresës nr. 2720 prot., datë 03.04.2015, informon Gjykatën

se për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 286, datë 08.02.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë janë ndjekur procedurat ligjore për ekzekutimin vullnetar dhe më tej për ekzekutimin e detyrueshëm. Mbas veprimeve përkatëse përmbarimore rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e ka ekzekutuar pjesërisht titullin ekzekutiv. Ajo e ka përmblusur detyrimin vetëm për sa i përket vlerës financiare, ndërsa detyrimi për rikthimin në punë ngelet ende pa veprim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuesit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individidi, në kuptim të neneve 131, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “g” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 6, datë 31.03.2006; nr. 27, datë 20.06.2007; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata vlerëson se kërkuesi *prima facie* ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e një vendimi gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe se në rastin konkret u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së tij. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kërkuesi i është drejtuar subjektit të interesuar, i cili është organi kompetent për të përmblusur detyrimin e përcaktuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë.

15. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për t’iu drejtuar kësaj Gjykate, pasi nuk ka mjet tjetër ligjor për konstatimin e cenimit të parimit të procesit të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.



B. Për pretendimin për mosëkzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm

16. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 25, datë 26.02.2015; nr. 17, datë 23.04.2013, nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 25, datë 26.02.2015; nr. 17, datë 23.04.2013; nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka rikonfirmuar në disa vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet nr. 25, datë 26.02.2015; nr. 17, datë 23.04.2013, nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po ashtu, Gjykata, duke u bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në mënyrë të vazhdueshme ka thënë se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit dhe të autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 25, datë 26.02.2015; nr. 17, datë 23.04.2013; nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

i) Për kompleksitetin e çështjes

20. Gjykata ka theksuar vazhdimisht se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkruesore (*shih vendimet nr. 14, datë 15.04.2010, nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se çështja në shqyrtim nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka përcaktuar detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë dhe të Degës së Tatimeve Vlorë që të dëmshpërblejnë kërkuarin Hamdi Bajramaj me 12 muaj pagë dhe ta rikthejnë atë në vendin e mëparshëm të punës. Në kushtet kur dispozitivi i vendimit gjyqësor është i qartë dhe i përcaktueshëm, nuk rezulton ndonjë vështirësi mbi përcaktueshmërinë e detyrimeve financiare të debitorit kundrejt kreditorit dhe rikthimin e tij në punë. Për më tepër, pagesat e kryera nga debitori janë tregues se ekzekutimi i këtij detyrimi nuk paraqet vështirësi.

ii) Për interesin dhe sjelljen e kërkuarit

22. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Në çështjen konkrete sjellja e kërkuarit përcaktohet nga qëndrimi i tij gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit. Rezulton që kërkuari jo vetëm nuk është bërë pengesë për realizimin e procesit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin e tij të plotë.



23. Mbështetur në aktet e paraqitura rezulton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Pasi vendimi ka marrë formë të prerë, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit dhe në vijim në datën 27.05.2009 ka depozituar pranë Zyrës së Përmbarimit Tiranë kërkesën për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor. Nga këto fakte rezulton se sjellja e kërkuetit nuk ka shkaktuar vonesa, përkundrazi ka ekzistuar interesi i ligjshëm i tij i shoqëruar me veprimet përkatëse, me qëllim realizimin e detyrimit që rrjedh nga një vendim i formës së prerë.

iii) Për sjelljen e autoriteteve

24. Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëloj (*shih vendimet nr. 7, datë 27.02.2012; nr. 35, datë 27.10.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Asnjë organ i administratës publike nuk mundet, duke ushtruar autoritetin e tij publik, qoftë edhe për realizimin e një qëllimi të ligjshëm publik, të pengojë apo të vonojë ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë të dhënë në një gjykim në të cilin ai ka qenë palë (*shih vendimet nr. 20, datë 04.04.2014, nr. 42, datë 19.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim përmbaruesi gjyqësor privat, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, ka qenë i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Nga dokumentet e administruara në gjykim rezulton se nga përmbaruesi gjyqësor janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme, por që kanë rezultuar të pasuksesshme për sa i takon kthimit në punë të kërkuetit nga ana e palës debitore.

25. Subjekti i interesuar, DPT-ja, është shprehur se vlera monetare në favor të kërkuetit është ekzekutuar tërësisht nëpërmjet urdhërpagesave dhe se koha brenda së cilës është ekzekutuar ky detyrim ka qenë e ndërvarur nga rrethana të veçanta që lidheshin kryesisht me mungesën e fondeve. Ndërsa për sa i përket rikthimit në punë të kërkuetit, DPT-ja e konsideron veten në pamundësi objektive për të realizuar këtë detyrim, pasi sistemimi i tij në punë nuk mund të bëhet tej strukturës dhe organikës së këtij institucioni.

26. Gjithashtu, pala debitore, përveçse e konsideron veten në pamundësi, e quan edhe të paligjshëm detyrimin që ka ndaj kërkuetit për kthimin në punë. Për këtë qëndrim të saj ajo parashtroi para Gjykatës faktin se bazuar në legjislacionin në fuqi dhe praktikën njehsuese të Gjykatës së Lartë e drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore. Për më tepër, në kushtet kur kërkuesi nuk ka gëzuar statusin e nëpunësit civil, ai nuk mund të kthehet në vendin e punës në asnjë rast.

27. Gjykata vëren se pala debitore ka vazhduar me ekzekutimin e detyrimit financiar, i cili rezulton i përmbushur tërësisht në vitin 2014, por ende nuk ka përmbushur detyrimin për rikthimin në punë të kërkuetit.

28. Gjykata në jurisprndencën e saj është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme për këtë rast, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimet nr. 10, datë 01.03.2012; nr. 2, datë 01.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2012; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2012; nr. 8, datë 23.03.2010; nr. 6, datë 06.03.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata çmon se në lidhje me pagimin e pagës, si pjesë e detyrimit të përcaktuar me vendimin gjyqësor të formës së prerë, edhe pse rezulton i përmbushur, konstatohet cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi kohëzgjatja e përmbushjes së këtij detyrimi prej 7 vitesh është e pajustificuar në raport me vlerën monetare të detyrimit dhe aftësinë paguese të institucioneve shtetërore.



30. Gjykata çmon se pretendimi i subjektit të interesuar që detyrimi për rikthimin në punë të kërkuesit është i paligjshëm, është i pabazuar për sa kohë që detyrimi për kthimin e tij në punë rrjedh nga një vendim gjyqësor. Për më tepër një qëndrim i tillë është në kundërshtim të hapur me nenin 142 të Kushtetutës, ku parashikohet se organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore. Gjithashtu, Gjykata vëren se subjekti i interesuar për të paraqitur pretendimet e tij për një vendim gjyqësor duhet t'u drejtohet instancave të zakonshme gjyqësore, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural.

31. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm, është i bazuar dhe duhet pranuar³.

C. Për pretendimin për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror

32. Gjykata çmon se kërkuesi nuk legjitimohet në këtë kërkim, pasi nuk është në kompetencë të Gjykatës të shqyrtojë dhe të vlerësojë dëmin pasuror e jopasuror të shkaktuar për arsye që lidhen me moszbatimin e një vendimi gjyqësor. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se ky është një kërkim i ri, i cili mund të paraqitet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në bazë të dispozitave të Kodit Civil, që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit të shkaktuar si rrjedhim i vonesës në pagimin e një shume parash (*neni 450 i Kodit Civil*). Vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike që parashikon ligji, kërkuesi mund të vërë në lëvizje procedurat kushtetuese, në bazë të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 39, datë 19.11.2013; nr. 31, datë 25.03.2011; nr. 8, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati

të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 286, datë 08.02.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

- Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 53, datë 20.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.03.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 12 Akti, që i përket:

KËRKUES: Altin Gusho

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë.

³ Gjyqtarët S.Berberi, A.Xhoxhaj, B.Imeraj dhe F.Lulo votuan për konstatimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor vetëm për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor për rikthimin në punë të kërkuesit.



OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2012-2695 (532), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 42, 44, 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 1 i Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenet 2, 28, 29, 30 dhe 81, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtimet e subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i cili kërkoj rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi Altin Gusho prej datës 01.06.1997 ka kryer detyrën e specialistit të Policisë Kriminale pranë Komisarariatit të Policisë Korçë. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me urdhrin nr. 1464, datë 23.06.2006, e ka përjashtuar kërkuësin nga radhët e policisë me motivacionin: “Për shkelje të betimit, për veprime që cenojnë në mënyrë të pariparueshme ligjin dhe detyrën, si dhe për abuzime të rënda me atributet e policisë dhe me mirëbesimin e publikut”.

2. Kërkuesi, me cilësinë e paditësit, ka paditur Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, duke paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë padi me objekt: “Anulimin e urdhrit nr. 1464, datë 23.06.2006 të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për zgjidhjen e kontratës së punës në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil. Detyrimin e palës së paditur për shpërblimin e dëmit si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës në mënyrë të paligjshme”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2889, datë 20.04.2007, ka vendosur: “Pranimin e padisë. Anulimin e urdhrit nr. 1464, datë 23.06.2006 të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Detyrimin e palës së paditur t’i

paguajë palës paditëse dëmshpërblimin si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës në masën e pagës së një viti”.

4. Mbi ankimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 972, datë 20.05.2008, ka vendosur: “Lëniën në fuqi të vendimit nr. 2889, datë 20.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

5. Mbi rekursin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2695 (532), datë 22.11.2012, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 972, datë 20.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 2889, datë 20.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj.

II

6. **Kërkuesi Altin Gusho** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-2695 (532), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me argumentet që vijojnë:

6.1 Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Kërkuesi ka pretenduar se nuk ka qenë në dijeni të rekursit të depozituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe për këtë arsye nuk ka marrë pjesë në seancën e zhvilluar në Gjykatën e Lartë.

6.2 Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke bërë interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve të administruara dhe të vlerësuara nga gjykatat më të ulëta, ka vepruar jashtë kompetencave të tij. Arsyetimi i vendimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë bie ndesh me provat e administruara dhe të vlerësuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

7. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**, paraqiti parashtime me shkrim si vijojnë:

7.1 Pretendimi i kërkuësit se është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë, pasi nuk ka marrë dijeni për rekursin, është i pabazuar. Njoftimet janë kryer duke respektuar dispozitat ligjore procedurale dhe Gjykata e Lartë e ka zhvilluar



gjykimin në mungesë, sepse asnjë nga palët nuk është paraqitur në gjykim dhe shkak për mosparaqitjen nuk ka pasur.

7.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë është i mbështetur dhe i bazuar në nenin 485/d të KPC-së, si pasojë pretendimi i kërkuarit se vendimi cenon parime kushtetuese është i pabazuar.

8. **Drejtoria e Përgjithshme e Qarkut Korçë** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim lidhur me kërkesën për gjykim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata paraprakisht thekson se ajo i vlerëson pretendimet e kërkuarit në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor, konkretisht, në aspektin e detyrimit të Gjykatës së Lartë për respektimin e këtyre standardeve.

A. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

10. Kërkuari ka pretenduar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë nuk ka marrë dijeni për rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, duke iu cenuar e drejta e aksesit në gjykatë. Sipas kërkuarit, dëftesa e komunikimit të rekursit nuk është nënshkruar prej tij, por prej të atit të tij dhe mungon data e marrjes dijeni. Në dëftesë është vetëm nënshkrimi i personit që ka bërë njoftimin, por nuk mund të identifikohet emri i tij.

11. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 7, datë 27.02.2013, nr. 14, datë 26.03.2012; nr. 4, datë 23.02.2011; nr. 14, datë 3.06.2009; nr. 7 datë 11.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështjen konkrete, bazuar në procesverbalin e seancës së datës 22.11.2012 të

zhvilluar në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë, rezulton se kërkuari Altin Gusho ka marrë dijeni rregullisht për njoftimin e shpalljes së datës 07.11.2012 dhe nuk është evidentuar asnjë shkak për mosparaqitje. Bazuar në materialet e dosjes gjyqësore rezulton se adresa në të cilën është komunikuar ankimi është e njëjtë me adresën ku është komunikuar rekursi. Fletëthirrja për ankimin është nënshkruar nga nëna e tij, ndërsa fletëthirrja e komunikimit të rekursit është nënshkruar prej të atit të kërkuarit.

13. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, konkretisht të së drejtës së aksesit si pasojë e mosnjoftimit të rekursit, është i pabazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

14. Kërkuari ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë një vendim tej kompetencave të tij, duke bërë një interpretim të ndryshëm të provave dhe fakteve të marra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Kolegji Civil, duke bërë rivlerësim të provave të marra dhe të administruara nga gjykatat më të ulëta, ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Arsyeimi i vendimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë bie ndesh me provat e administruara dhe të vlerësuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë.

15. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë*



24.06.2013; nr. 22, datë 22.07.2009; nr. 7, datë 09.03.2009; nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese është shprehur se “nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar, ndërkohë që nga përmbajtja e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta rezulton e provuar e kundërta. Nëse Kolegji Civil arrin në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat më të ulëta, atëherë ai duhet të prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë për rigjykim çështjen në gjykatën e shkallës së parë dhe në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit në shkallët më të ulëta gjyqësore. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, i trajtuar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (*shih vendimet nr. 36, datë 30.06.2014; nr. 27, datë 24.06.2013; nr. 7, datë 09.03.2009; 17, datë 30.04.2007; nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjatë shqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtëm të kontrollit të ligshmërisë dhe të bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe të rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe e apelit, por pa i ndryshuar ato (*shih vendimin nr. 31, datë 01.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen konkrete, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2889, datë 20.04.2007, ka vendosur pranimin e padisë duke arsyetuar se urdhri i largimit të kërkuesit nga detyra nuk ka qenë i bazuar në ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe se veprimet e kryera prej tij gjatë detyrës nuk kanë qenë të kundërligjshme, arbitrare apo veprime që bien ndesh me kryerjen e detyrës, duke mos shkaktuar përgjegjësi disiplinore ndaj kërkuesit. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendim ka arsyetuar se për kërkuesin është vendosur pushimi i procedimit penal të nisur nga

Prokuroria e Rrethit Korçë, pasi është vërtetuar se ai nuk ka qenë në detyrë ditën kur ka ndodhur ngjarja penale për të cilën ka nisur si procedimi penal, ashtu edhe ai disiplinor. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 972, datë 20.05.2008.

19. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2695 (532), datë 22.11.2012, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 972, datë 20.05.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 2889, datë 20.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj. Nga përmbajtja e vendimit nr. 00-2012-2695 (532), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë rezulton se janë parashtruar vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilat kanë vendosur pranimin e padisë së kërkuesit, si dhe shkaqet e rekursit të ushtruar nga subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

20. Gjykata konstaton se kolegji në vendim ka arsyetuar: “Në veprimet e kërkuesit janë konstatuar një sërë shkeljesh të kryera, të cilat janë pasqyruar në shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënies së punë. Shkelje të tilla si: parregullsitë e konstatuara në përpilimin e informacionit të shërbimit, mosaktësimi i kohës dhe vendit të marrjes së informacionit, siç kërkohet nga neni 99, pika 3, i Rregullores së Shërbimit të Policisë së Shtetit, si dhe mungesa e emrit apo inicialeve të personit informues lidhur me autorët e mundshëm të vjedhjes përbëjnë shkelje të kryera, që kanë lidhje me detyrën e tij. Po kështu mënyra e marrjes së intervistës me të shoqëruarin nuk është realizuar në përputhje me Rregulloren”. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe atij të Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe rrëzimin e padisë, duke arritur në përfundimin se veprimet e kryera nga kërkuesi janë në kundërshtim me ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe se urdhri i largimit është i drejtë.

21. Gjykata çmon se kolegji ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë duke rivlerësuar provat e administruara e të vlerësuara nga këto gjykata. Kolegji duke arsyetuar se kërkuesi ka pasur përgjegjësi disiplinore jo vetëm ka arritur në një përfundim të kundërt me atë të



gjykatave më të ulëta, por është mjaftuar vetëm me një paragraf në arsyetimin e qëndrimit të tij.

22. Gjykata Kushtetuese konstaton se në çështjen konkrete, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke bërë rivlerësim të fakteve e provave të vlerësuara nga Gjykata e Faktit dhe ajo e Apelit, ka ndryshuar në themel vendimet e gjykatave më të ulëta, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

23. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të tij të njohura nga ligji procedural civil, duke marrë një vendim në papajtueshmëri me parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

24. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit Altin Gusho për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-2695 (532), datë 22.11.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari

VENDIM

Nr. 54, datë 20.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 28.05.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 26 Akti, që i përket:

KËRKUES: Astrit Duraku

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria “Ndërtuesi 10” sh.p.k.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-3595, datë 12.12.2014 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131/f, 134/1/g dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Astrit Duraku, në cilësinë e njërit prej trashëgimtarëve ligjorë të S.D. dhe bashkëpronar i pasurisë së paluajtshme truall 227 m², me numër regjistri hipotekor 648, datë 30.09.1960, ka lidhur me subjektin e interesuar shoqëria “Ndërtuesi 10” sh.p.k. kontratën e



sipërmarrjes me nr. 2445 rep. dhe nr. 196 kol., datë 25.04.2002, si dhe ka nënshkruar dy deklarata noteriale (datë 24.04.2002 dhe 25.04.2002). Në bazë të këtyre akteve palët kanë rënë dakord që subjekti i interesuar të ndërtojë një pallat 8 deri në 10 kate përkundrejt përfuturit nga kërkuesi të përqindjeve të caktuara të sipërfaqes ndërtimore të pallatit. Duke qenë se kërkuesi ka pretenduar se sipërfaqet takuese nuk i janë dorëzuar në kohë, ai i është drejtuar gjykatës për përmbushjen e detyrimeve nga subjekti i interesuar sipas këtyre akteve, si dhe për pagesën e vlerës së qirasë së banesës për moszbatimin e afatit të ndërtimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 769, datë 16.02.2005, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të padisë. Detyrimin e palës së paditur “Ndërtuesi 10” sh.p.k. që për efekt të deklaratës noteriale nr. 2015 rep. dhe 372 kol., datë 24.04.2002 t’i japë paditësit Astrit Duraku sipërfaqe apartamenti banimi 67 m², sipërfaqe dyqani 28.35 m² dhe sipërfaqe garazhi 30.09 m². Pushimin e gjykimit të padisë për pjesën tjetër të saj. Ligjërimin e masës së padisë për pjesën tjetër të saj”.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 474, datë 26.04.2006, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 769, datë 16.02.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 337, datë 21.03.2007, ka vendosur prishjen e vendimeve të mësipërme gjyqësore dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, me një tjetër trup gjykues.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4365, datë 25.05.2011 ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur [...] t’i dorëzojë paditësit [...] apartament banimi [...] sipërfaqe ndërtimore për banim [...], sipas mundësive që verifikohen në momentin e ekzekutimit të vendimit ose kundërvlerën e saj sipas çmimit të përcaktuar [...] dyqanin nr. 2 me sipërfaqe 55 m². Ligjërimin e masës së padisë për pjesën e pranuar të objektit. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të kërtimeve”.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 240, datë 01.02.2012, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. 4365, datë 25.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3595, datë 12.12.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër vendimeve nr. 240, datë 01.02.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 4365, datë 25.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

II

8. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në këto drejtime:

8.1 Është cenuar *parimi i paanshmërisë*, pasi njëri prej gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë.

8.2 Është cenuar standardi *i arsytimit* të vendimit gjyqësor, pasi në vendimin e Kolegjit Civil nuk janë pasqyruar shkaqet e ngritura në rekurs.

8.3 Është cenuar *e drejta për t’iu drejtuar* gjykatës dhe për të marrë zgjidhje ligjore për pretendimet e ngritura para saj.

9. **Subjekti i interesuar** në pretendimet me shkrim para Gjykatës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës bazuar në këto argumente:

9.1 Fakti që gjyqtari A.B. ka marrë pjesë në trupin gjykues që ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe njëherazi në Gjykatën e Lartë (GJL) nuk mund të shërbejë si shkak për shfuqizimin e vendimit të GJL-së, pasi në gjykimin në apel ky gjyqtar ka votuar pro kërtimeve të kërkuesit, ndërsa gjykimi në dhomë këshillimi kufizohet vetëm në vlerësimin nëse çështjet e ngritura në rekurs plotësojnë ose jo kriteret e parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

9.2 Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka pasqyruar në mënyrë të plotë e të detajuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe është rrjedhim i një gjykimi brenda kufijve ligjorë të shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit.

9.3 Gjithashtu, pretendimi për cenim të së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës është i pabazuar, pasi kërkuesi ka marrë përgjigje përfundimtare dhe të arsyetuar nga gjykatat për të gjitha kërkesat e parashtruara para tyre.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

10. Gjykata vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individit, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2014-3595, datë 12.12.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 22, datë 22.07.2009; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Ajo ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “F”, të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 03.06.2009; nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në standardet e mësipërme Gjykata vëren se argumentet e kërkuarit në mbështetje të pretendimeve për parregullsi të gjykimit në

Gjykatën e Lartë lidhen me respektimin e parimit të paanshmërisë, standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e aksesit në gjykim. Në këto kushte, nisur nga natyra *prima facie* e këtyre pretendimeve, Gjykata çmon se vlerësimi i tyre përfshihet në juridiksionin kushtetues.

B. Për cenimin e parimit të paanshmërisë

13. Kërkuari ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi njëri prej gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka gjykuar çështjen në Gjykatën e Apelit Tiranë.

14. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

15. Në këtë kuadër, Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohen nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit të Gjykatës së Lartë. Gjykata ka theksuar se “...thjesht dhe vetëm pjesëmarrja e një apo më shumë gjyqtarëve në një procedim të mëparshëm, pavarësisht nga ndikimi i prezencës dhe i mendimit të tyre në të gjithë trupin gjykues, është një arsye e



mjaftueshme dhe njëkohësisht një garanci më pak për kërkuesin, tek i cili është krijuar dyshimi i bazuar se gjykata nuk ka qenë e paanshme në shqyrtimin e kësaj çështjeje. Dyshimi i mundshëm për paanësinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtut fakt në lidhje me të njëjtin subjekt” (*shih vendimet nr. 7, datë 07.03.2011; nr. 21, datë 29.04.2010; nr. 48, datë 30.07.1999 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë qëllim dhe në funksion të këtij parimi të rëndësishëm kushtetues parashikohen edhe dispozita të veçanta ligjore. Kështu, në nenin 72 të KPC-së, ku parashikohen rastet për heqjen dorë të gjyqtarit, theksohet shprehimisht se “gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur [...] ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit”.

17. Gjykata vlerëson se edhe në rastin në shqyrtim paanshmëria duhet të vlerësohet në aspektin subjektiv dhe në atë objektiv. Për sa i takon paanshmërisë personale (*subjektive*) të gjyqtarit A.B., pra bindjes së brendshme të tij për mënyrën e zgjidhjes së çështjes konkrete, nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim, ndaj ajo prezumohet. Për sa i përket paanshmërisë objektive, duhet shqyrtuar nëse dyshimi i ngritur nga kërkuesi është i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete.

18. Gjykata vëren se në rastin konkret kërkuesi e mbështet pretendimin për paanshmërinë e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në faktin se ai ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit. Konkretisht, siç konstatohet nga vendimet gjyqësore bashkëlidhur kërkesës, rezulton se gjyqtari A.B. ka qenë në përbërje të trupit gjykues i cili ka shqyrtuar çështjen në themel në Gjykatën e Apelit Tiranë (*vendimi nr. 240, datë 01.02.2012*) dhe në përbërje të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër këtij vendimi.

19. Gjykata është shprehur edhe herë të tjera se është e papranueshme që një gjyqtar që ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të gjykimin të jetë sërish në

përbërje të Kolegjit të Gjykatës së Lartë që do të shqyrtojë e vlerësojë shkaqet e rekursit që janë kundër këtij vendimi (*shih vendimin nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është pjesë e rëndësishme e procesit gjyqësor në tërësi dhe si e tillë, duhet të respektojë parimet themelore të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

20. Mbi këtë bazë, Gjykata vëren se pjesëmarrja e gjyqtarit A.B. duhej të ishte mënjeluar nga përbërja e Kolegjit Civil të mbledhur për shqyrtimin e rekursit të kërkuesit. Vetë kërkuesi nuk e ka pasur mundësinë që të kërkonte përjashtimin e gjyqtarit nga trupi gjykues në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, pasi ai nuk ka qenë i pranishëm.

21. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të paanshmërisë është i bazuar dhe si i tillë duhet pranuar.

C. Për pretendimet e tjera të paraqitura nga kërkuesi

22. Në lidhje me pretendimet e tjera të paraqitura në kërkesë, më konkretisht për cenimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë për arsye se Gjykata e Lartë nuk është shprehur lidhur me problemet juridike të ngritura në rekurs, si dhe nuk ka paraqitur në vendim shkaqet e rekursit, Gjykata vlerëson se përderisa ka konstatuar më sipër se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë ka qenë jokushtetues, për shkak të cenimit të parimit të paanshmërisë, ajo nuk ndalet në vlerësimin e këtyre pretendimeve.

23. Si përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret është cenuar parimi i gjykimin nga një gjykatë e paanshme, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si rrjedhim kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,



VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-3595, datë 12.12.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 55, datë 21.7.2015

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 16.12.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 60/28 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i togfjalëshit “dhe në doza të vogla”, në paragrafin e parë të nenit 283 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Nenet 124, 131/a, 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 29 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Faqe|9762

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altina Xhoxhaj, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (*gjykata referuese*) është paraqitur për gjykim nga ana e Prokurorisë çështja penale me nr. regjistri 514 (01133) ndaj të pandehurit D.Sh., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal (KP), sipas të cilit: “*Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet...*”.

2. Gjykata referuese ka vlerësuar se togfjalëshi “*dhe në doza të vogla*”, në paragrafin e parë të nenit 283 të KP-së, është i papajtueshëm me nenin 17 të Kushtetutës. Për këto arsye, me vendimin e datës 23.09.2014, ajo ka pezulluar gjykimin e kësaj çështjeje dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për kontrollin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së kësaj dispozite.

II

3. Gjykata referuese ka parashtruar këto argumente përpara Gjykatës për të mbështetur qëndrimin e saj për jokushtetutshmërinë e normës së kundërshtuar:

3.1 Thelbi i lirisë së personit i garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, duhet të kufizohet nga pushteti shtetëror vetëm për mbrojtjen e interesave publike dhe në atë masë sa të jetë e domosdoshme për arritjen e këtyre qëllimeve. Togfjalëshi “*dhe në doza të vogla*” vjen në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi nëpërmjet parashikimit të mbajtjes së lëndëve narkotike për përdorim personal në të njëjtën dispozitë me shitjen dhe transportimin e lëndëve narkotike për qëllime fitimi, cenohet balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik të pretenduar.



3.2 Cenimi i lirisë personale, sipas nenit 283/1 të KP-së, nuk përputhet me asnjë qëllim të ligjshëm për një veprim me një rrezikshmëri kaq të ulët për shoqërinë. Argumentet e përgjithshme të luftës kundër krimit ose sigurisë publike nuk përligjin kufizimin disproporcional të lirisë së qytetarëve.

3.3 Sipas nenit 283/1 të KP-së ligjvënësi ka parashikuar të njëjtat marzhe dënimi si për shitjen e transportimin, ashtu edhe për mbajtjen e lëndëve narkotike për përdorim personal (përveç kur mbahet në doza të vogla). Fakti se pikat 1 dhe 2, të nenit 283, parashikojnë marzhe në minimum dhe në maksimum nuk është argument që mund të legjitimojë parashikimin në të njëjtën dispozitë të dy veprimeve me rrezikshmëri cilësisht dhe në mënyrë sasiore të ndryshme.

3.4 Në kushtet kur as në Kodin Penal, as në ligjin për barnat nuk parashikohen referenca mbi sasinë konkrete apo kriteret e vlerësimit të dozave të vogla, kjo çështje është trajtuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin unifikues nr. 1, datë 27.03.2008 (*vendimi nr. 1/2008*), i cili është i detyrueshëm për zbatim. Bazuar në këtë vendim, edhe pse në rastin konkret u provua në gjykim se i pandehuri është përdorues i lëndës narkotike, ai duhet të deklarohet fajtor dhe të dënohet me një dënim nga 7-15 vite burgim, çka vjen në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës.

3.5 Togfjalëshi “dhe në doza të vogla” ndryshon kuptimin e penalizimit të mbajtjes së lëndëve narkotike për përdorim personal. Shfuqizimi i këtij togfjalëshi nuk cenon luftën kundër fenomenit kriminal të shitjes, shpërndarjes, tregimit, transportimit, dorëzimit, ose edhe mbajtjes (për qëllime shitjeje apo ofrimi të tjerëve) të substancave narkotike dhe psikotrope. Po ashtu, shfuqizimi nuk pengon ligjvënësin në miratimin e një dispozite të re penale, ku të parashikojë më vete, edhe me dënime proporcionale, sipas rrezikshmërisë së veprimeve përkatëse, mbajtjen e lëndëve narkotike për përdorim personal (p.sh. duke parashikuar dënime sipas llojit të substancës apo sasisë së lëndës së sekuestruar).

4. **Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë**, në parashtimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

4.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e ngritura prej saj janë të natyrës ligjore, për pasojë i takojnë juridiksionit të zakonshëm.

4.2 Veprimet e shitjes, transportimit apo shpërndarjes së lëndëve narkotike konsiderohen si veprime të rrezikshme për shoqërinë dhe për këtë arsye ligjvënësi ka parashikuar dënime për to, ndërkohë që për përdorimin vetjak dhe në doza të vogla ligjvënësi e ka përjashtuar shprehimisht përgjegjësinë penale.

4.3 Në mungesë të përcaktimit të ligjvënësit se çfarë konsiderohet dozë e vogël, Gjykata e Lartë me vendimin unifikues nr. 1/2008 ka interpretuar këtë parashikim në kuptimin që në aspektin sasior lënda narkotike dhe psikotrope duhet të jetë në atë masë sa të konsiderohet realisht e vogël për përdorim vetjak nga ana e individit konkret. Po ashtu, Gjykata e Lartë ka theksuar se përcaktimi i dozës së vogël duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës dhe rast pas rasti.

4.4 Një përcaktim i tillë i nocionit “doza të vogla”, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të KP-së, përveç rolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve, luan edhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundërligjshëm të këtyre lëndëve.

4.5 Me parashikimin e nenit 283/1 të KP-së ligjvënësi ka ruajtur balancën ndërmjet të drejtës së kufizuar dhe interesit publik. Për shkak të dëmit që shkaktojnë në shëndetin e përdoruesve, lëndët narkotike dhe konsumimi i tyre nga një numër i madh personash janë një plagë e shoqërisë.

5. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, në parashtimet me shkrim drejtuar Gjykatës ka prapësuar sa vijon:

5.1 Gjykata referuese nuk ka sjellë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për papajtueshmërinë e nenit 283/1 të KP-së me nenin 17 të Kushtetutës. Ajo nuk ka vlerësuar siç duhet kriterin e lidhjes së drejtpërdrejtë mes shkaqeve të ngritura dhe zgjidhjes së çështjes prej saj. Gjykata referuese nuk pengohet për ta zgjidhur në themel çështjen, pasi edhe nëse hipotetikusht do të shpallet si jokushtetuese dispozita e kundërshtuar, kjo nuk e pengon gjykatën për dhënien e një vendimi fajësie apo pafajësie për të pandehurin.



5.2 Konventa e OKB-së, në nenin 3/2 të saj, e lë në vullnetin e shteteve palë parashikimin ose jo si vepër penale të mbajtjes/zotërimit, blerjes apo kultivimit të drogave, të kryer me qëllim përdorimin personal, duke rekomanduar që për këtë kategori përveç dënimit mund të parashikohen për autorët edhe masa të tjera edukuese dhe rehabilituese.

5.3 Ndryshimi i paragrafit të parë të nenit 283 të KP-së me ligjin nr. 8733/2001, duke përjashtuar nga përgjegjësia penale mbajtësin e lëndës narkotike për përdorim vetjak në dozë të vogël, si dhe rritja e masës së dënimit jo vetëm ka rritur standardin e ligjit, por ka ulur edhe kufizimin e të drejtave dhe lirive të përdoruesve në përpjesëtim me gjendjen shqetësuese që përbën ky fenomen për shoqërinë.

5.4 As togfjalëshi “dozë e vogël” në paragrafin e parë të nenit 283 të KP-së, i shtuar si kriter sasie për përdorimin vetjak, as vendimi unifikues nr. 1/2008 i Gjykatës së Lartë nuk kufizojnë të drejtat dhe liritë e individit apo gjykatat në vlerësimin, rast pas rasti, bazuar në prova (ku përfshihet edhe mendimi i ekspertit), nëse fakti përbën vepër penale ose jo.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

6. Përpara se të shprehet në lidhje me thelbin e pretendimeve, Gjykata do të ndalet në vlerësimin e legjitimitetit të gjykatës referuese, i vënë në dyshim nga subjektet e interesuara, Ministria e Drejtësisë dhe Prokuroria e Përgjithshme. Sipas këtyre subjekteve, pretendimet e ngritura në kërkesë janë të natyrës ligjore, për pasojë ato i takojnë juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Po ashtu, ato pretendojnë se gjykata referuese nuk ka dhënë argumente të mjaftueshme dhe bindëse për papajtueshmërinë e nenit 283/1 të KP-së me nenin 17 të Kushtetutës, si dhe nuk ka vlerësuar siç duhet kriterin e lidhjes që duhet të ekzistojë mes zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë dhe zgjidhjes së çështjes konkrete prej saj.

7. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës, sipas të cilit kur gjyqtari çmon se ligji (ose dispozita të tij) bie në

kundërshtim me Kushtetutën, nuk e zbaton atë, por pezullon gjykimin dhe ia dërgon çështjen Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e normës. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili përcakton edhe disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës.

8. Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa iu dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuptim kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese. Po ashtu, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 12, datë 14.04.2010; nr. 30, datë 17.06.2010; nr. 7, datë 27.02.2013; nr. 39 datë 30.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 7, datë 16.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).



9. Duke e vlerësuar legjitimitimin e gjykatës referuese në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret plotësohen kriteret për iniciimin e gjykimit incidental. Gjykata referuese është vënë në lëvizje me kërkesë të Prokurorisë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit D.SH., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, sipas paragrafit të parë të nenit 283 të KP-së. Në këto kushte dispozita e kundërshtuar është ligji i zbatueshëm në rastin konkret. Po ashtu, gjykata referuese ka identifikuar raportin e domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, ka identifikuar parimet kushtetuese me të cilat, sipas saj, bie në kundërshtim dispozita e kundërshtuar, si edhe ka argumentuar se nuk ka pasur mundësi të interpretimit të ligjit në pajtim me Kushtetutën dhe për këtë arsye nuk mund të përdorte mekanizëm tjetër veç atij të vënies në lëvizje të gjykimit incidental për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës.

10. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykata referuese legjitimohet t’i drejtohet asaj për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën, të përmbajtjes së paragrafit të parë të nenit 283 të KP-së.

B. Për pretendimin për cenimin e nenit 17 të Kushtetutës

11. Gjykata referuese ka vënë në dyshim kushtetutshmërinë e përmbajtjes së paragrafit të parë të nenit 283 të KP-së, duke pretenduar se togfjalëshi “dhe në doza të vogla” në këtë dispozitë cenon nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk respekton balancën ndërmjet së drejtës së kufizuar dhe interesit publik që synohet të arrihet. Cenimi i lirisë së një individi konsumator të lëndës narkotike dhe që e mban atë në sasi të caktuar për përdorim vetjak nuk përputhet me asnjë qëllim të ligjshëm për një veprim me një rrezikshmëri kaq të ulët për shoqërinë. Sipas saj, ligjvënësi ka një larmi zgjidhjesh, që nga dënimet plotësuese, dënimet me gjobë, dënimet alternative dhe vetëm si mjet i fundit (*extrema ratio*) mund të përdoret burgimi, në rastet kur rrezikshmëria e veprës dhe e autorit është e tillë që meriton privimin e lirisë.

12. Gjykata vëren se sipas nenit 27/1 të Kushtetutës askujt nuk mund t’i hiqet liria,

përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Sipas pikës 2 të po këtij neni liria e personit mund të kufizohet vetëm kur, mes të tjerash, ai është dënuar me burgim nga gjykata kompetente. Në përputhje me nenin 17, të Kushtetutës, liria e personit mund të cenohet vetëm për mbrojtjen e një interesi publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke respektuar në çdo rast parimin e proporcionalitetit, i cili është edhe testi i përgjithshëm kushtetues për të përcaktuar se deri në çfarë mase mund të shtrihet ky kufizim. Prandaj parimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes merr domethënie edhe më të madhe në lidhje me vlerësimin e dispozitave penale që përcaktojnë dënimet, duke qenë se këto përbëjnë masat më të rënda që mund të vendosë shteti ndaj atyre veprimeve të individëve, të cilat janë parashikuar si vepra penale.

13. Gjykata ka theksuar se legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme të tilla si, pavarësia e shtetit dhe tërësia e tij territoriale, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendi kushtetues, prona etj. (neni 1/b i KP-së). Ai bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit (neni 1/c i KP-së). Rëndësi të veçantë në fushën penale, sidomos në atë të parashikimit të dënimeve dhe ekzekutimit të tyre, zë mbrojtja e të drejtave të njeriut. Për pasojë, në përputhje me kërkesat e parimit të proporcionalitetit, çdo dënim duhet të jetë në raport të drejtë me rrezikshmërinë e veprës penale dhe me shkallën e fajit të autorit (*shih vendimin nr. 47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata rithekson se ligjvënësi është përgjegjës për hartimin e politikave penale, pra për marrjen e tërësisë së masave me karakter penal, që synojnë të parandalojnë kriminalitetin në një vend dhe një kohë të caktuar, si dhe për përcaktimin e strategjisë së përgjithshme të luftës kundër kriminalitetit në vend dhe në këtë drejtim ligjvënësit i njihen hapësira për zgjidhje diskrecionale që i rezervohen vetëm atij. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit ligjvënësi, lidhur me vlerësimin e mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimin që kërkohet të arrihet, ka një hapësirë të



lirë dhe të gjerë veprimi, e cila mund të shqyrtohet në shkallë të kufizuar nga kjo Gjykatë (*shih vendimin nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Proporcionalitetin e një kufizimi Gjykata e vlerëson rast pas rasti duke pasur parasysh disa aspekte, si balancën mes të drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, si dhe të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë ligjvënësi. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra tjetrën. Sipas Gjykatës balanca mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik nuk është gjë tjetër veçse gjetja nga ana e ligjvënësit e pikës së ekuilibrit midis detyrimit të shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit, nga ana tjetër.

16. Në kuptim të parimit të proporcionalitetit, një ligj që kufizon të drejtat themelore duhet të jetë i nevojshëm dhe i përshtatshëm për të arritur qëllimin. Një ligj është i nevojshëm në rast se ligjvënësi nuk ka pasur mundësi të zgjidhte një mjet tjetër, i cili mund të ishte efektiv në të njëjtën mënyrë, por mund të cenonte në një masë më të vogël ose aspak të drejtat themelore dhe është i përshtatshëm kur me ndihmën e tij mund të arrihet rezultati i kërkuar. Në arritjen e përfundimit nëse një mjet i caktuar është më i nevojshmi dhe më i përshtatshmi për të arritur qëllimin e kërkuar, ligjvënësi ka një hapësirë të gjerë vlerësimi. Kjo hapësirë ekziston edhe në lidhje me vlerësimin dhe parashikimin e rrezikut që mund t'u vijë individëve dhe shoqërisë. Për sa i përket balancës mes seriozitetit të ndërhyrjes, nga njëra anë, dhe rëndësisë së faktorëve që justifikojnë vendimarrjen, nga ana tjetër, duhet të vlerësohet se çfarë kufijsh mund t'u vendosen personave të cilëve ligji u adresohet dhe deri në çfarë mase, por duke pasur parasysh që kjo barrë nuk duhet të jetë joproporcionale. Është thelbësore për ligjvënësin të përcaktojë se cilat janë ato veprime të individit që konsiderohen të dënueshme dhe në këtë kuptim nuk i takon Gjykatës të përcaktojë nëse ky vlerësim është mënyra më e përshtatshme, më e arsyeshme ose e duhura, por roli i saj është të kontrollojë nëse përmbajtja e vetë dispozitës penale është e pajtueshme me të drejtat, liritë dhe parimet themelore kushtetuese.

17. Bazuar në konsideratat e mësipërme Gjykata duhet të vlerësojë nëse përmbajtja e nenit 283/1 të KPP-së cenon kërkesën e proporcionalitetit të ndërhyrjes, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës.

18. Gjykata vëren se dispozita e nenit 283 të KP-së (miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995) fillimisht ka pasur këtë përmbajtje: *“Prodhimi, përzierja, përgatitja, shpërndarja, mbajtja, ofrimi për shitje, shitja, shpërndarja me çdo mënyrë, transportimi i çdo lloji droge narkotike ose substance psikotrope në kundërshtim me dispozitat ligjore, dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet...”* Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8175, datë 23.12.1996, neni 283 u ndryshua, duke përfshirë në të vetëm prodhimin, përzierjen, përgatitjen e paligjshme të narkotikëve, si dhe u shtua neni 283/a me këtë përmbajtje: *“Transporti, importimi, eksportimi, mbajtja, shitja, dhënia falas ose blerja e paligjshme e narkotikëve përbën trafik të narkotikëve dhe dënohet me trembëdhjetë vjet burgim...”*. Me ndryshimet e fundit që iu janë bërë këtyre dispozitave me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, neni 283 i titulluar “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” u riformulua me këtë përmbajtje: *“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”*

19. Gjykata vëren se ligjvënësi ka ndërhyrë në periudha të ndryshme në legjislacionin penal, duke përcaktuar vepra të reja penale të dënueshme, si dhe duke ndryshuar llojet e masave të dënimit për t'iu përgjigjur shqetësimeve të shoqërisë si pasojë e zhvillimit të kriminalitetit, në veçanti krimin të organizuar. Sipas parashtrimeve të subjekteve të interesuara, synimi i ligjvënësit ka qenë sigurimi i rendit publik e shoqëror dhe rritja e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale, si një mënyrë për të dekurajuar shtetasit që të ndërmarrin veprime në kundërshtim me ligjin.



20. Gjykata vëren se ligjvënësi, në kuadër të luftës kundër trafikimit, shpërndarjes dhe përdorimit të lëndëve narkotike, ka bërë edhe ndryshimet përkatëse në nenin 283 të KP-së, duke vlerësuar se për të arritur këtë qëllim është e nevojshme të ndalohet çdo lloj veprimi që ka të bëjë me këto substanca, përfshirë edhe mbajtjen e tyre. Sipas Gjykatës, nëse ligjvënësi vlerëson se një parashikim i tillë për dënimin me burgim të këtyre veprave penale është mjeti më i përshtatshëm dhe eficient për mbrojtjen e interesave të përgjithshme në fjalë dhe nuk ka argumente për ndërhyrje ose masa të tjera më pak kufizuese, atëherë kjo është e pranueshme nga pikëpamja kushtetuese.

21. Sipas parashtimeve të Kuvendit, parashikimi i nenit 283/1 të KP-së, përveç rolit parandalues për shëndetin e personave përdorues, luan edhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundërligjshëm të këtyre lëndëve, i cili kur gjen përhapje në përmasa të mëdha shndërrohet në patologji sociale. Në penalizimin e veprimeve që kanë të bëjnë me lëndët narkotike, qëllimi i ligjvënësit është mbrojtja e shëndetit si të individit, ashtu edhe të gjithë shoqërisë kundër rrezikut që buron nga këto substanca. Po ashtu, synohet edhe mbrojtja e popullsisë, veçanërisht e të rinjve nga përdorimi dhe krijimi i varësisë ndaj tyre. Për arritjen e këtij qëllimi nuk mjafton vetëm parashikimi i dënimeve për ato veprime ose mosveprime që shkaktojnë një rrezik të menjëhershëm ndaj shëndetit, por synohet të kontrollohet edhe ndikimi social, në mënyrë që të ndalohen efektet e dëmshme shoqërore në këtë drejtim. Në vlerësimin e ligjvënësit tregtimi, transportimi, shitja apo shpërndarja e lëndëve narkotike nuk janë të vetmet veprime që përbëjnë një rrezik potencial, pasi edhe blerja, edhe mbajtja e këtyre lëndëve paraqesin gjithashtu rrezik, për shkak se krijojnë mundësinë që ato të shpërndahen te palët e treta, pra të kalojnë nga një individ tek tjetri pa asnjë kontroll. I njëjti rrezik ekziston edhe në rastin kur përdoruesi e blen dhe e mban lëndën narkotike vetëm me qëllimin për të siguruar bazën e nevojshme për konsum personal, pasi në vetvete edhe kërkesat për blerje të lëndëve narkotike për përdorim personal krijojnë premisat për

zhvillimin dhe zgjerimin e tregut të lëndëve narkotikëve.

22. Ligjvënësi ka një interes legjitim për dënimin e këtyre veprave penale dhe në këtë kuptim parashikimi i dënimit penal edhe për rastet e blerjes apo mbajtjes së lëndëve narkotike përbën një masë të përgjithshme parandaluese. Duke penalizuar edhe përdoruesit që mbajnë sasi jo të vogla lëndësh narkotike, arrihet të pengohet përdorimi nga individët e tjerë për shkak të evitimit të shpërndarjes më me lehtësi të tyre. Rreziku që lëndët narkotike të shpërndahen në këtë mënyrë ekziston edhe nëse qëllimi i shkelësit në rastin e blerjes dhe të mbajtjes së këtyre substancave është vetëm ai i përdorimit personal.

23. Edhe pse rreziku që buron nga mbajtja për përdorim personal në sasi më të mëdha të lëndës narkotike është më i vogël se ai që rrjedh nga veprimet e tjera të parashikuara nga neni 283 i KP-së, ligjvënësi legjitimohet të niset nga prezumimi se edhe nga ky lloj veprimi lind një rrezik. Duke qenë se veprimet e konsumatorëve të lëndëve narkotike nuk ndikojnë vetëm te individ, pasi këto lloj dukurish zhvillohen në një kontekst social, është detyrë e shtetit të parandalojë rreziqet që mund të prekin qytetarët/individët e tjerë. Në këtë kuptim, qëndrimi i përgjithshëm i mbajtur nga ligjvënësi për të parashikuar dënime penale edhe për këto raste nuk përbën cenim të parimit të proporcionalitetit, pasi kjo justifikohet nga qëllimi që kërkohet të arrihet dhe që është mbrojtja e popullsisë, veçanërisht e të rinjve, nga rreziqet që shkaktohen nga lëndët narkotike. Ligjvënësi ka arsye të justifikuar për të vlerësuar se këto shkelje meritojnë dhe kërkojnë dënim. Në lidhje me veprat penale që kanë të bëjnë me lëndët narkotike dhe psikotrope ligjvënësi e ka shtrirë mbrojtjen në të gjitha llojet e veprimeve, të cilat janë të afta të sjellin të tilla rreziqe dhe kjo justifikohet si një masë e përgjithshme me karakter parandalues.

24. Gjykata, duke pasur parasysh të dhënat nga studime të ndryshme, vlerëson se ashpërsimi jo proporcional i dënimeve penale nuk ka pasur gjithmonë ndikim pozitiv ose ndikimi ka qenë në një masë të tillë që mund të konsiderohej i papërfillshëm në arritjen e qëllimeve të legjislacionit penal. Veprat penale mbulojnë një shkallë të gjerë veprimesh ose mosveprimesh, të



cilat dallojnë mes tyre për sa i përket natyrës së shkeljes dhe rrezikut që i kanoset interesit që ligji synon të mbrojë. Në varësi të karakteristikave dhe efekteve të lëndës narkotike, si dhe natyrës së shkeljes konkrete jo vetëm fajësia e individit, por edhe rreziku ndaj interesit publik të mbrojtur mund të jetë aq i vogël saqë vendimi për marrjen e masave të përgjithshme parandaluese mund ta humbë qëllimin dhe vlerën e tij. Kjo për arsye se nëse blerja dhe mbajtja e substancave narkotike kufizohet në sasi të vogla, për përdorim vetjak të rastit, rreziku konkret që këto lëndë të kalojnë te një person i tretë nuk është domethënës, për pasojë interesi publik për të vendosur dënime në këto raste është i kufizuar. Një qëndrim i kundërt mund të çojë në një rezultat që është disproporcional në lidhje me efektet e tij ndaj përdoruesve vetjakë.

25. Edhe në këtë drejtim Gjykata vlerëson se përmbajtja e nenit 283 të KP-së, i cili përjashton nga ndjekja penale individët që mbajnë lëndë narkotike për përdorim vetjak dhe në doza të vogla, ka respektuar kërkesën kushtetuese të proporcionalitetit, të sanksionuar në nenin 17 të Kushtetutës. Vetëm në këto raste shkelja e kryer konsiderohet e tillë që nuk ka asnjë interes publik për ndjekjen penale të tyre dhe në miratimin e këtij parashikimi ligjvënësi ka respektuar balancën midis fajësisë të autorit, rrezikshmërisë së veprës penale dhe masës ndëshkuese të saj.

26. Gjykata thekson se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Në këtë kuptim, në përputhje me parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, ligjvënësi, në miratimin e nenit 283/1 të KP-së, ka lejuar gjykatat që në individualizimin e dënimit në çështjet konkrete të kenë parasysh shkallën e fajit nisur jo vetëm nga lloji i lëndës narkotike, por edhe nga sasia që i është gjetur individit të ndaluar, duke iu lejuar në këtë mënyrë ushtrimin e diskrecionit në lidhje me vlerësimin e të gjitha elementeve të veprës penale. Neni 283/1 i KP-së kërkon në mënyrë të shprehur që rrezikshmëria

shoqërore e veprës ose e të pandehurit të jetë e vogël dhe për pasojë të mos paraqesë një interes publik për ndjekjen penale apo dënimin e tij, çka plotësohet në rastet e përdorimit personal që nuk përfshijnë palë të treta. Por në rastet kur ajo përfshin rrezikun ndaj palëve të treta, p.sh. nëse kryhet në ambiente publike (p.sh. në shkollë) ose nga persona të caktuar, të cilët janë përgjegjës për edukimin e të rinjve (p.sh. një mësues), dhe është e tillë që mund të nxisë të tjerët drejt përdorimit të këtyre lëndëve, atëherë vlerësohet se faji i të pandehurit është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin publik për ushtrimin e ndjekjes penale dhe dënimin e tij. Për pasojë, në zbatimin e nenit 283/1 të KP-së, më shumë sesa një qasje abstrakte e bazuar në konsiderata me karakter të përgjithshëm, duhet nisur nga vlerësimi i rrethanave konkrete dhe kontekstit në të cilin kryhen veprimet në fjalë.

27. Në të njëjtën linjë me sa më sipër është edhe vendimi unifikues nr. 1, datë 27.03.2008 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i referuar nga kërkuuesi, i cili ka interpretuar dispozitën e kundërshtuar të nenit 283 të KP-së në këtë mënyrë: “... *Doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike e psikotrope që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve vlerësohet si dozë e vogël... Përcaktim i tillë i nocionit “në doza të vogla”, për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të KP-së, veç rolit parandalues që luan për ruajtjen e shëndetit të përdoruesve dhe personave që kanë vartësi nga droga, luan dhe rolin e parandalimit të përgjithshëm në drejtim të luftës kundër fenomenit të përdorimit të kundërligjshëm të këtyre lëndëve, i cili kur gjen përhapje në përmasa të mëdha, shndërrohet në patologji sociale... Bazuar në sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se përdoruesi i lëndëve narkotike, i cili e mban atë jo për përdorim vetjak, qoftë edhe në doza të vogla, kur është shpërndarës i saj në një nga format që parashikon neni 283/1 i KP-së, ka përgjegjësi penale sipas kësaj dispozite. Çmojnë gjithashtu se, përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të KP-së, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret, mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope.”*



28. Gjykata vëren se në lidhje me sasinë që do të konsiderohet si “e vogël”, Gjykata e Lartë nuk ka përcaktuar ndonjë kriter apo kufizim, por ka vlerësuar se kjo bëhet rast pas rasti. Ndaj çdo gjykatë, gjatë shqyrtimit të çështjeve konkrete, nuk ka asnjë pengesë që rast pas rasti të vlerësojë nëse sasia që i është gjetur të pandehurit përmbush kërkesën e nenit 283/1 të KP-së. Në kushtet kur interpretimi i dhënë nga Gjykata e Lartë nuk është shterues dhe nuk jep asnjë përcaktim sasior të asaj çka do të konsiderohet dozë e vogël, gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitës konkrete, nuk kanë asnjë pengesë që ta interpretojnë dhe zbatojnë atë në përputhje me parimet kushtetuese, duke pasur parasysh rast pas rasti kriteret që zbatohen në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit.

29. Gjykata vlerëson se duke qenë se nga ana e gjykatës referuese është pretenduar se ka paqartësi në mënyrën se si interpretohet dhe zbatohet parashikimi i nenit 283/1 të KP-së, për shkak të mospërcaktimit të kufirit të zbatueshëm për vlerësimin e dozës së vogël, i takon ligjvënësit të monitorojë mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite specifike për të arritur në konkluzionin nëse ka një zbatim uniform të saj ose nëse është e nevojshme marrja e masave të tjera në këtë drejtim.

30. Për të gjitha argumentet e paraqitura më sipër, Gjykata vlerëson se togfjalëshi “dhe në doza të vogla”, në paragrafin e parë të nenit 283 të KP-së, nuk bie ndesh me përmbajtjen e nenit 17 të Kushtetutës, për pasojë kërkesa e paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është e pabazuar dhe duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “d” dhe 145, pika 2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj
Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka vendosur rrëzimin e kërkesës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me deklarinimin si antikushtetues të togfjalëshit “dhe në doza të vogla” në paragrafin e parë të nenit 283 të Kodit Penal, i ndryshuar. Shumica ka vlerësuar se përmbajtja e nenit 283 të KP-së, i cili përjashton nga ndjekja penale individët që mbajnë lëndë narkotike për përdorim vetjak dhe në doza të vogla, ka respektuar kërkesën kushtetuese të proporcionalitetit, të sanksionuar në nenin 17 të Kushtetutës. Vetëm në këto raste shkelja e kryer konsiderohet e tillë që nuk ka asnjë interes publik për ndjekjen penale të tyre dhe në miratimin e këtij parashikimi ligjvënësi ka respektuar balancën midis fajësisë të autorit, rrezikshmërisë së veprës penale dhe masës ndëshkuese të saj (*shih paragrafin 25 të vendimit*).

2. Shumica, nisur nga fakti se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, si dhe bazuar në vendimin unifikues nr. 1, datë 27.03.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar se ligjvënësi në miratimin e nenit 283/1 të KP-së ka lejuar gjykatat që në individualizimin e dënimit në çështjet konkrete të kenë parasysh shkallën e fajit nisur jo vetëm nga lloji i lëndës narkotike, por edhe nga sasia që i është gjetur individit të ndaluar, duke iu lejuar në këtë mënyrë ushtrimin e diskrecionit në lidhje me vlerësimin e të gjitha elementeve të veprës penale. Neni 283/1 i KP-së kërkon në mënyrë të shprehur që rrezikshmëria shoqërore e veprës ose e të pandehurit të jetë e vogël dhe për pasojë të mos paraqesë një interes publik për ndjekjen penale apo dënimin e tij, çka plotësohet në rastet e përdorimit personal që nuk përfshijnë palë të treta (*shih paragrafin 26-27 të vendimit*).

3. Ndërsa në lidhje me sasinë që do të konsiderohet si “e vogël”, shumica, duke qenë se Gjykata e Lartë në vendimin e lartpërmendur nuk ka përcaktuar ndonjë kriter apo kufizim, ka vlerësuar se çdo gjykatë, gjatë shqyrtimit të



çështjeve konkrete, nuk ka asnjë pengesë që rast pas rasti të vlerësojë nëse sasia që i është gjetur të pandehurit përmbush kërkesën e nenit 283/1 të KP-së (*shih paragrafin 28 të vendimit*). Po në këtë kontekst shumica, lidhur me paqartësinë në mënyrën se si interpretohet dhe zbatohet parashikimi i nenit 283/1 të KP-së, të pretenduar nga gjykata referuese, ka arritur në përfundimin se për shkak të mospërcaktimit të kufirit të zbatueshëm për vlerësimin e dozës së vogël, i takon ligjvënësit të monitorojë mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite specifike për të arritur në konkluzionin nëse ka një zbatim uniform të saj ose nëse është e nevojshme marrja e masave të tjera në këtë drejtim (*shih paragrafin 29 të vendimit*).

4. Përpjekjet e shumicës për të argumentuar arsyet e rrëzimit të kërkesës i gjejmë të sforçuara dhe kontradiktore. Ndryshe nga shumica, ne gjyqtarët në pakicë, mendojmë se Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e saj.

5. Sikurse argumenton edhe shumica, ligjvënësi ka ndërhyrë në periudha të ndryshme në legjislacionin penal, duke përcaktuar vepra të reja penale të dënueshme, si dhe duke ndryshuar llojet e masave të dënimit për t'iu përgjigjur shqetësimeve të shoqërisë si pasojë e zhvillimit të kriminalitetit, në veçanti krimit të organizuar (*shih paragrafin nr. 19 të vendimit*).

6. Edhe dispozita e nenit 283 të KP-së (miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995), sikurse vëren edhe shumica, ka pësuar disa ndryshime. Fillimisht ajo ka pasur këtë përmbajtje: *“Prodhimi, përzierja, përgatitja, shpërndarja, mbajtja, ofrimi për shitje, shitja, shpërndarja me çdo mënyrë, transportimi i çdo lloj droge narkotike ose substance psikotrope në kundërshtim me dispozitat ligjore, dënohen me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet...”*. Të gjitha ndryshimet e mëvonshme të bëra nga ligjvënësi, sipas pikëpamjes tonë, e kanë komplikuar zbatimin e saj duke krijuar kushte për interpretime dhe vlerësime subjektive, të njëanshme dhe të ndryshme nga gjykata në gjykatë.

7. Kështu me ligjin nr. 8175, datë 23.12.1996 neni 283 u ndryshua, duke përfshirë në të vetëm prodhimin, përzierjen dhe përgatitjen e paligjshme të narkotikëve, si dhe u shtua neni 283/a me këtë përmbajtje: *“Transporti, importimi, eksportimi, mbajtja, shitja, dhënia falas ose blerja e*

paligjshme e narkotikëve përbën trafik të narkotikëve dhe dënohet me trembëdhjetë vjet burgim...” Me ndryshimet e fundit që iu janë bërë këtyre dispozitave me ligjin nr. 8733, datë 24.01.2001, neni 283 i titulluar *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”* u riformulua me këtë përmbajtje: *“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohen me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.”* (*shih paragrafin nr. 18 të vendimit*).

8. Ndryshe nga shumica jemi të mendimit se formulimi fillestar i dispozitës në fjalë, përpara ndryshimeve të vitit 2001, nuk paraqiste probleme apo boshllëqe në kuadër të luftës kundër kriminalitetit apo të përdorimit të paligjshëm të substancave narkotike. Ligjvënësi duke parashikuar si vepër penale, ndërmjet të tjerave, edhe *“mbajtjen ... në çdo mënyrë”* të çdo lloj droge narkotike ose substance psikotrope në kundërshtim me dispozitat ligjore, kishte përmbushur edhe qëllimin që synohej të arrihej me ligjin e 2001, pra atë të ndalimit të çdo lloj veprimi që ka të bëjë me këto substanca, përfshirë edhe mbajtjen e tyre (*shih paragrafin nr. 20 të vendimit*). Në vlerësimin tonë ky synim arrihet edhe me formulimin e ri të nenit 283 të KP-së, pa qenë e nevojshme edhe përfshirja e togfjalëshit *“përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla”*, pasi *“marrja në çdo formë”* e lëndëve narkotike, e parashikuar nga kjo dispozitë, përfshin në vetvete edhe mbajtjen e tyre.

9. Neni 283 i KP-së është dispozitë referuese. Sipas formulimit të këtij neni *“shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi ... i substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike”* janë të dënueshme penalisht vetëm kur ato kryhen *“në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre”*. Konkretisht, në ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 *“Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”*, përveç sa më sipër, në nenet 64 dhe vijues janë parashikuar dhe rastet e përdorimit të lëndëve të tilla për personat në mjekim, në tabelat përkatëse dhe sipas recetave të mjekut.



Ndonëse ligji në fjalë ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë për të përcaktuar me akt nënligjor kushtet dhe kriteret e shitjes së barnave, ky detyrim ende nuk është përmbushur prej saj!

10. Për të qenë më të qartë në këto prapësime, i gjithë togfjalëshi “*përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla*” jo vetëm krijon konfuzion dhe paqartësi në zbatimin korrekt dhe efektiv të kësaj dispozite në praktikë, por është njëkohësisht edhe “parazit”, përderisa këto çështje rregullohen dhe duhet të rregullohen me amendime në ligjin e lartpërmendur, si dhe në aktet nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatim të tij. Kjo është arsyeja që togfjalëshi “*dhe në doza të vogla*” duke qenë i paqartë krijon probleme të natyrës kushtetuese. Akoma më i paqartë rezulton edhe vendimi unifikues nr. 1, datë 27.03.2008 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili edhe pse ka interpretuar dispozitën e kundërshtuar të nenit 283 të KP-së, ka vlerësuar se “*përcaktimi i dozës së vogël të lëndës narkotike e psikotrope, për efekt të zbatimit të dispozitës së nenit 283 të KP-së, duhet të bëhet me ndihmën e specialistëve të fushës (toksikologë etj.), të thirrur si ekspertë dhe rast pas rasti, jo vetëm sipas llojit të lëndës narkotike e psikotrope, por edhe të cilësive fiziko-biologjike dhe shkallës së vartësisë nga droga të personit konkret, mbajtës i lëndës narkotike dhe psikotrope*”, kur në fakt këto janë çështje që i përkasin ligjvënësist.

11. Në kuadër të respektimit të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka theksuar se vetë siguria juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (vendimi nr. 9, datë 26.02.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, që vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t’i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (vendimi nr. 36, datë 15.10.2007; nr. 52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

12. Gjithashtu, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se mungesa e harmonizimit të dispozitave të një ligji me ato të ligjeve të tjera mund të mos krijojë në vetvete antikushtetutshmëri, por kur paqartësia krijon probleme të tilla, që çojnë në zbatim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në cenim të parimit të shtetit të së drejtës e të sigurisë juridike, atëherë nuk mund të pranohet se këto norma janë të pajtueshme edhe me frymën e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nisur nga sa më sipër, mendojmë se parashikimi në të njëjtin nen të Kodit Penal i shitjes, i prodhimit të substancave narkotike dhe i përdorimit vetjak të tyre, si dhe mungesa në legjislacion e rregullimeve që përcaktojnë sasi të maksimale të përdorimit të çdo lënde narkotike, e bëjnë dispozitën të paplotë, të paqartë, duke krijuar probleme me zbatimin në praktikë të saj. Madje interpretimi i bërë nga vendimi unifikues i lartpërmendur i Gjykatës së Lartë, mendojmë se u hap rrugë vlerësimeve subjektive të gjyqtarëve dhe ekspertëve të fushës, duke përkeqësuar në mënyrë të ndjeshme problemet ekzistuese në sistemin gjyqësor.

14. Edhe në dritën e një këndvështrimi krahasues në aspektin ndërkombëtar, tendenca që vihet re në legjislacionet e shumë rendeve juridike⁴ është përcaktimi i kufijve për të vlerësuar përdorimin në doza të vogla të çdo lënde narkotike, çka e bën akoma dhe më evidente paqartësinë në zbatimin e dispozitës objekt shqyrtimi.

15. Gjithashtu, një formulim i tillë vlerësojmë se bie ndesh edhe me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë përpara ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit, në të cilat bazohet legjislacioni penal sipas parashikimit të nenit 1/c të KP-së.

⁴ Në Itali përdorimi personal i lëndëve narkotike parashikohet nga neni 75 i ligjit nr. 309/1990, i përditësuar, ndërsa me dekretet të Ministrisë së Shëndetësisë janë përcaktuar dozat maksimale të përdorimit të secilës prej lëndëve narkotike.

Në Gjermani shumica e Landave kanë miratuar një kufi (kufi i lartë/kufi i ulët) për të vlerësuar “sasi të vogla” të disa lëndëve narkotike.

Në Çeki Kodi Penal përkufizon posedimin e “më shumë se një sasi të vogël droge”, ndërsa sasia e vogël është përcaktuar në vendimin e qeverisë nr. 467/2009 Coll.



16. Në vijim të këtij arsyetimi, jemi të mendimit se shumica nuk mund t'i anashkalonte këto aspekte dhe ta bazonte vendimin e saj vetëm në rrethanën nëse përmbajtja e nenit 283/1 të KPP-së cenon kërkesën e proporcionalitetit të ndërhyrjes, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Gjithashtu, dhënia përgjigje pretendimit për paqartësinë e normës nuk mund të përfundonte me gjetjen nga ana e shumicës se *“i takon ligjvënësit të monitorojë mënyrën e zbatimit të kësaj dispozite specifike për të arritur në konkluzionin nëse ka një zbatim uniform të saj ose nëse është e nevojshme marrja e masave të tjera në këtë drejtim”* (shih paragrafin 29 të vendimit). Përkundrazi, në momentin që gjykata referuese ka ngritur pretendimin mbi paqartësinë në zbatimin e normës, para Gjykatës qëndronte detyrimi për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi.

17. Si përfundim, jemi të mendimit se togfjalëshi “dhe në doza të vogla” në paragrafin e parë të nenit 283 të Kodit Penal, i ndryshuar bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, pasi nuk garanton parimin e sigurisë juridike, të barazisë përpara ligjit dhe të ligjshmërisë së dënimit.

18. Në këtë këndvështrim, mendojmë se kërkesa e Gjykatës së Rrethi Gjyqësor Shkodër duhej pranuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Vladimir Kristo

VENDIM

Nr. 56, datë 21.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën - 07.05.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 15 Akti, që i përket:

Faqe/9772

KËRKUES: Yzeir Miraka

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Shoqëria “Delfi” sh.p.k., Naun Panxhi, Petrit Panxhi

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Petrit Panxhi dhe Naun Panxhi, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka paditur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan subjektet e interesuara, duke kërkuar, ndër të tjera, detyrimin e të paditurve të lirojnë pjesën e zaptuar të pronës së tij (nr. 8/77, në zonën kadastrale 8522) dhe dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar kësaj prone. Kërkesëpadia është paraqitur në datën 20.06.2012 dhe është regjistruar në datën 21.06.2012 me nr. akti 454/111/101/23. Shorti për gjykimin e saj i ka rënë gjyqtarës M.Ç. Kjo gjyqtare, pasi ka zhvilluar dy seanca, është larguar për arsye familjare (leje lindjeje). Është rihedhur shorti dhe është caktuar si gjyqtar B.M. në datën 09.12.2012. Kërkuesi ka parashtruar se gjykimi nuk ka përfunduar në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe nuk është marrë ende një vendim në lidhje me të.

2. Gjithashtu, kërkuesi e ka kallëzuar penalisht gjyqtarin B. M. në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 26.05.2014.

3. Kërkuesi i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) në datën 16.10.2013, duke paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit B. M. për zvarritjen e procesit civil, ku kërkuesi është palë



ndërgjyqëse. KLD-ja pasi ka kryer inspektimin në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, është shprehur në shkresën nr. 2995/2 prot., datë 26.02.2014 drejtuar kërkesit se “zvarritja e procesit ka ardhur për shkak të planifikimit dhe organizimit jo të mirë të punës nga ana e gjyqtarit [...]”. Nga analiza e të dhënave ka rezultuar se gjykimi i kësaj çështjeje nuk është përfunduar brenda afatit kohor standard, referuar vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 të KLD-së [...] dhe duke pasur në konsideratë standardin kushtetues të nenit 42 të Kushtetutës është arritur në përfundimin se zvarritja e procesit gjyqësor ka cenuar të drejtat kushtetuese të palëve për realizimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm kohor”. Për shkak të përjashtimit të gjyqtarit B.M., në datën 08.07.2014 është rihedhur shorti elektronik dhe ai është zëvendësuar nga gjyqtari R. A.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë vendim në lidhje me çështjen e themelit gjatë kohës që kërkesa e paraqitur nga kërkuesi ka qenë në proces shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me vendimin nr. 394 (13-2015-1871), datë 27.03.2015.

II

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ai ka pretenduar se gjyqtari B.M., që është caktuar të gjykojë padinë e tij, e ka zvarritur çështjen gjyqësore duke e vonuar 24 muaj gjykimin e saj. Ky fakt sipas kërkesit është vënë në dukje edhe nga KLD-ja, e cila nga hetimi i dosjes ka arritur në përfundimin se është shkelur nga gjyqtari vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010 i KLD-së dhe e drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Kërkuesi ka evidentuar në kërkesë faktin e mospërfundimit të gjykimit në shkallë të parë dhe mosmarrjen e vendimit nga gjykata në lidhje me çështjen e themelit.

6. **Subjektet e interesuara**, Petrit Panxhi dhe Naun Panxhi, kanë parashtruar si vijon:

6.1 Ndërtimi i bërë prej tyre nuk e ka dëmtuar pronën e kërkesit, por është bërë në tokën pronar i së cilës është Petrit Panxhi.

6.2 Kërkuesi jo vetëm që nuk ka paraqitur

asnjë garanci monetare për masën e sigurimit të vendosur nga gjykata (pezullim i punimeve), por ka kallëzuar në mënyrë të padrejtë Naun Panxhin në prokurori për shkatërrim prone dhe ndërtim të paligjshëm.

6.3 Kërkuesi e ka zvarritur vetë procesin gjyqësor me kërkesat e tij para Prokurorisë dhe para gjykatës për përjashtimin e gjyqtarëve.

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese III

A. Për legjitimin e kërkesit

7. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë. Gjykata ka konstatuar se në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe shqyrtimit paraprak të saj gjykimi i themelit nuk kishte përfunduar ende në Gjykatën e Shkallës së Parë.

8. Në kuptim të nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuenin që për zgjidhjen e çështjes së tij t’u drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi legjitimohet vetëm kur shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 17, datë 07.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në vendimin e saj nr. 12, datë 05.03.2012 Gjykata ka nënvizuar se detyrimi i ankuesve për shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që këto mjete të jenë të pranishme në sistemin juridik të vendit, si dhe të përmbushin kriteret që kërkon KEDNJ-ja (neni 13). Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), efekti i nenit 13 të Konventës kërkon



parashikimin e një mjeti juridik të brendshëm për të trajtuar themelin e një “ankese të pranueshme” në bazë të Konventës dhe për të dhënë një kompensim të përshtatshëm (*shih çështjen Gjyli kundër Shqipërisë, datë 07.12.2010*). Ekzistenca e këtyre mjeteve juridike duhet të jetë mjaftueshëm e qartë jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, në të kundërt atyre do t’u mungojë kushti i aksesit dhe i efektivitetit (*shih vendimin e pranueshmërisë në çështjen Lehtinen v. Finland, aplikimi nr. 39076/97, §5*). Gjithashtu, “autoriteti”, të cilit i referohet neni 13 i Konventës, nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një autoritet gjyqësor, por në qoftë se ky autoritet nuk është i tillë, pushtetet/kompetencat e tij dhe garancitë që ai ofron janë të rëndësishme për të përcaktuar nëse ky autoritet përbën një mjet efektiv. Gjithashtu, edhe sikur një mjet i vetëm të mos i plotësojë kërkesat e nenit 13, tërësia e mjeteve të ofruara në bazë të së drejtës së brendshme mund t’i plotësojë (*shih Silver dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 5947/73, § 113*).

10. Gjykata është shprehur se lidhur me pretendimin për shkeljen e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ajo shqyrton nëse ka pasur mjete të cilave pala kërkuese duhet t’u drejtohej në plotësim të kushtit të shterimit të mjeteve. Në këtë drejtim, sipas jurisprudencës së Gjykatës, në kuptim të nenit 13 të Konventës, mjetet në dispozicion të një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë “efektive” në qoftë se ato “parandalojnë shkeljen e pretenduar, pengojnë vazhdimin e saj ose ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur” (*shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese, i cili i referohet vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Scordino kundër Italisë, nr. 1, aplikimi nr. 36813/97, § 183 e 186, cituar në vendimin për çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 10508/02, §75 e 76*).

11. Nga aktet e administruara konstatohet se kërkuesi i është drejtuar KLD-së për t’u ankuar ndaj veprimeve të gjyqtarit, të kryera në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, të cilat i kishin cenuar atij të drejtën për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata, bazuar në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, vëren se në kuptim të nenit 13 të Konventës autoriteti para të cilit mund të

parashikohet mundësia e fillimit të një procesi për të provuar cenimin e së drejtës, jo domosdoshmërisht mund të jetë një autoritet gjyqësor (gjë që nënkupton edhe mundësinë e të qenit të tij një autoritet administrativ), por nëse nuk është i tillë, pushtetet e tij dhe garancitë të cilat ai ofron janë kryesore në përcaktimin nëse mjeti përpara tij është efektiv (*shih Silver dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar supra*). Gjykata në këtë aspekt është shprehur se ligji nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, jo vetëm që nuk plotëson kushtet e veçanta të mjetit juridik për të mbrojtur dhe rivendosur të drejtën për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në veçanti, por as kushtet e përgjithshme të mjetit juridik, që janë aksesit dhe efektiviteti i tij. Konkretisht, sipas këtij ligji, KLD-së nuk i është njohur pushteti për të vendosur për pretendimin e cenimit të kësaj të drejte me anën e vendimeve ligjërish detyruese për të rivendosur të drejtën e shkelur, qoftë nëpërmjet një vendimi që të shpejtonte gjykimin duke parandaluar tejzgjatjen vazhduese të tij, qoftë nëpërmjet një vendimi me natyrë kompensuese, si kompensim i dëmit të ardhur nga tejzgjatja e paarsyeshme e gjykimit (*shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kërkuesi i është drejtuar, gjithashtu, Prokurorisë së Përgjithshme në datën 26.05.2014, duke depozituar kallëzim penal ndaj gjyqtarit B.M. për kryerjen e veprave penale të shpërdorimit të detyrës dhe kryerjes së veprimeve arbitrare, si dhe Avokatit të Popullit. Gjykata vlerëson se si kërkesa e depozituar në prokurori, ashtu edhe ankimi drejtuar Avokatit të Popullit nuk përbëjnë mjete efektive në kuptim të standardeve të mësipërme të jurisprudencës së Gjykatës dhe GJEDNJ-së.

13. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se sistemi juridik i vendit nuk parashikon mjete juridike për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepëruar të procesit gjyqësor ose pengimin e vazhdimit të kësaj shkeljeje përpara se t’i drejtohej Gjykatës Kushtetuese.

14. Për këto arsye, Gjykata, referuar qëndrimin të saj në vendimin nr. 12, datë 05.03.2012, vlerëson se kërkuesi legjitimohej t’i drejtohej Gjykatës në lidhje me kërkimin objekt kërkeje,



në momentin e paraqitjes së kërkesës, pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të kërkuarit ende nuk kishte përfunduar në të gjitha shkallët e gjyqkimit.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregull ligjor si rezultat i moszhvillimit të gjyqkimit brenda një afati të arsyeshëm, në shkelje të nenit 42/2 të Kushtetutës.

16. Sipas nenit 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 12, datë 05.03.2012; nr. 12, datë 15.04.2011; nr. 35, datë 27.10.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Lidhur me kompleksitetin e çështjes, Gjykata është shprehur se ka rëndësi vlerësimi i të gjitha aspekteve të çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shpresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 16, datë 21.03.2014; nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 9, datë 01.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, objekti i çështjes së themelit lidhet me lirimin e një pjese të pronës së kërkuarit dhe marrjen e dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar. Çështja nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike e juridike dhe as volum të konsiderueshëm shpresor, ndaj Gjykata çmon se nuk jemi në kushtet e rrethanave të veçanta që mund të justifikojnë vonesën në zhvillimin e gjyqkimit.

18. Për sjelljen e kërkuarit, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së

arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 4, datë 20.02.2013; nr. 50 datë 22.11.2011, nr. 14, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se në rastin konkret kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale dhe nga aktet e bashkëngjitura nuk rezulton që ai të jetë bërë pengesë për zhvillimin e gjyqkimit brenda një afati të arsyeshëm. Kërkuari i është drejtuar KLD-së, Avokatit të Popullit dhe Prokurorisë, duke identifikuar problemin e tejzgjatjes së procesit gjyqësor. Për pasojë, në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që sjelljet e kërkuarit të jenë bërë shkak për mosgjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, përkundrazi ai ka qenë aktiv në kërkimet e tij për rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar.

19. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve shtetërore, Gjykata vëren se është pikërisht sjellja e tyre që ka shkaktuar zvarritjen e procesit gjyqësor në dëm të kërkuarit. Nga shkresa nr. 99/1 prot., datë 06.02.2015 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në të cilën janë pasqyruar veprimet e kryera në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, rezulton se çështja gjyqësore me nr. akti 454/111/101/23, me paditës kërkuarin, është regjistruar në datën 21.06.2012. Çështja i është caktuar gjyqtarës M.Ç. Pasi kjo gjyqtare është larguar me leje lindjeje, çështja i ka kaluar gjyqtarit B.M. në datën 05.11.2012. Për shkak të përjashtimit të këtij gjyqtari, në datën 08.07.2014 është rihedhur shorti elektronik dhe ai është zëvendësuar nga gjyqtari R.A. Sipas kronologjisë së seancave të pasqyruar në shkresën e mësipërme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, konstatohet se deri në datën 21.01.2015, datë në të cilën seanca është shtyrë, gjykata ende nuk kishte marrë vendim në lidhje me themelin e çështjes. Ndërkohë që kërkesa e paraqitur nga kërkuari ka qenë në proces shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë vendim në lidhje me çështjen e themelit, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me vendimin nr. 394 (13-2015-1871), datë 27.03.2015. Duke marrë parasysh kohën që ka kaluar nga regjistrimi i çështjes deri në marrjen e vendimit (2 vjet e 9 muaj), Gjykata konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka zhvilluar një gjykim brenda afateve të arsyeshme.

20. Në përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit është i



bazuar dhe duhet pranuar, pasi si rrjedhojë e mosgjykimit brenda afatit të arsyeshëm atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

MENDIM PAKICE

1. Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka pranuar pretendimin e kërkesit Yzeir Miraka për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi si rrjedhojë e moszhvillimit të gjykimit brenda afateve të arsyeshme nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Shumica, në linjë me jurisprudencën e kësaj Gjykate (*shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese, i cili i referohet vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Scordino kundër Italisë, nr. 1, apl. nr. 36813/97, § 183, 186, cituar në vendimin mbi*

çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 10508/02, § 75 e 76), ka argumentuar se lidhur me pretendimin për shkeljen e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ajo shqyrton nëse ka pasur mjete të cilave pala kërkuese duhet t’u drejtohej në plotësim të kushtit të shterimit të mjeteve. Në këtë drejtim, sipas jurisprudencës së Gjykatës, në kuptim të nenit 13 të Konventës, mjetet në dispozicion në një ndërgjyqësi për të parashtruar një ankesë për zgjatjen e procesit janë “efektive” në qoftë se ato “parandalojnë shkeljen e pretenduar, pengojnë vazhdimin e saj ose ofrojnë një riparim të përshtatshëm për çdo shkelje që tashmë ka ndodhur” (*shih paragrafin nr. 10 të vendimit*).

3. Gjykata, në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, i cili sanksionon termin “ankim efektiv”, ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë mjete, sipas rastit, janë në dispozicion të individit dhe nëse ato i krijojnë atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë efektive. Në këtë drejtim është evidentuar se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv, duhet të jetë i përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 9, datë 15.03.2013; nr. 27, datë 20.06.2007; nr. 6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. GJEDNJ-ja, në shumë raste ka mbajtur qëndrimin se neni 13 i Konventës garanton ekzistencën në nivel kombëtar të mjeteve të cilat forcojnë thelbin e të drejtave dhe të lirive. Neni 13 kërkon parashikimin e një mjeti ankimi të brendshëm, i cili të merret me thelbin e “një kërkesë të argumentuar”, në kuptim të Konventës, dhe të garantojë lehtësira të përshtatshme. Qëllimi i detyrimit për shtetet kontraktuese, në kuptim të nenit 13, ndryshon në varësi të natyrës së ankimit të kërkesit, megjithatë mjeti i kërkuar duhet të jetë efektiv si në praktikë, ashtu edhe në ligj (*Ilban kundër Turqisë nr. 22277/93, prg. 97; Kudla kundër Polonisë nr. 30210/96, prg. 157*).

5. Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ-ja e ka trajtuar çështjen e efektivitetit të mjetit të ankimit



në një perspektivë më të gjerë, duke dhënë disa orientime lidhur me karakteristikat që duhet të ketë një mjet i brendshëm ankimi. GJEDNJ-ja ka konstatuar se mjeti më i mirë i ankimit, si në çdo fushë tjetër, është pa dyshim parandalimi. Ajo ka mbajtur në mënyrë të përsëritur qëndrimin se neni 6/1 imponon mbi shtetet kontraktuese detyrimin për t'i organizuar sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që gjykatat e tyre të mund të përmbushin secilën nga kërkesat e tij, veçanërisht për sa i përket afatit të arsyeshëm (*shih ndër të tjera Süßmann kundër Gjermanisë nr. 20024/92, prg. 55*). Kur sistemi gjyqësor ka mangësi në këtë drejtim, një mjet i projektuar për të përshpejtuar procedurat, me qëllim parandalimin e kohëzgjatjes së tepërt të procesit, përbën zgjidhjen më efektive. Një mjet i tillë ofron një avantazh të pamohueshëm në raport me një mjet i cili parashikon vetëm kompensimin, sepse jo vetëm eviton konstatimin e shkeljeve të njëpasnjëshme për të njëjtën procedurë, por nuk kufizohet vetëm në veprimin *a posteriori*, siç ndodh në rastin e një mjeti ankimi për kompensim. GJEDNJ-ja në shumë raste i ka njohur këtij lloji ankimi një karakter efektiv në masën që ai lejon përshpejtimin e vendimit gjyqësor në fjalë (*shih ndër të tjera Scordino kundër Italisë nr. 36813/97, prg. 184; Bacchini kundër Zvicrës nr. 62915/00, Tomé Mota kundër Portugalisë nr. 32082/96*).

6. Duke iu rikthyer rastit konkret, në paragrafin 19 të vendimit, Gjykata vëren se është pikërisht sjellja e autoriteteve shtetërore ajo që ka shkaktuar zvarritjen e procesit gjyqësor në dëm të kërkuarit. Nga shkresa nr. 99/1 prot., datë 06.02.2015 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në të cilën janë pasqyruar veprimet e kryera në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve, rezulton se çështja gjyqësore me nr. 454/111/101/23 akti, me paditës kërkuar, është regjistruar në datën 21.06.2012. Çështja i është caktuar gjyqtarës M.Ç. Pasi kjo gjyqtare është larguar me leje lindjeje, çështja i ka kaluar gjyqtarit B.M., në datën 05.11.2012. Për shkak të përjashtimit të këtij gjyqtari, në datën 08.07.2014 është rihedhur shorti elektronik dhe ai është zëvendësuar nga gjyqtari R.A. Sipas kronologjisë së seancave të pasqyruar në shkresën e mësipërme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, konstatohet se deri në datën 21.01.2015,

datë në të cilën seanca është shyrë, gjykata ende nuk kishte marrë vendim në lidhje me themelin e çështjes. Ndërkohë që kërkesa e paraqitur nga kërkuari ka qenë në proces shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë vendim në lidhje me çështjen e themelit, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me vendimin nr. 394 (13-2015-1871), datë 27.03.2015. Duke marrë parasysh kohën që ka kaluar nga regjistrimi i çështjes deri në marrjen e vendimit (2 vjet e 9 muaj), Gjykata konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk ka zhvilluar një gjykim brenda afateve të arsyeshme.

7. Pavarësisht konkluzionit të arritur më lart, nuk pajtohem me këtë qëndrim të mbajtur nga shumica për faktin se ndërkohë që kërkesa ka qenë në proces shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka marrë vendim në lidhje me çështjen e themelit, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me vendimin nr. 394 (13-2015-1871), datë 27.03.2015. Si rrjedhim, në kuptim të mjetit efektiv të ankimit, vendimi i Gjykatës është deklarativ dhe nuk sjell asnjë efekt për ecurinë e procesit për sa kohë çështja është mbyllur në këtë shkallë të gjykimit.

8. Në këto kushte, çmoj se shumica duhej ta rrëzonte kërkesën për sa kohë konstatimi i shkeljes së nenit 6/1 të Konventës efektivisht nuk sjell një rezultat konkret për kërkuar në drejtim të rivendosjes të së drejtës së tij të shkelur. Sipas qëndrimit tim, shumica duhet ta adresonte analizën edhe në drejtim të nenit 13 të Konventës dhe të vlerësonte efektivitetin e këtyre lloji ankimeve në Gjykatën Kushtetuese. Vendime të tilla kanë thjesht natyrë deklarative dhe formale dhe nuk riparojnë në thelb shkeljen e pretenduar.

Anëtar: Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuar Yzeir Miraka nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

2. Neni 131/f i Kushtetutës parashikon se individit mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese



për gjykimin përfundimtar të ankesave për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i zakonshëm gjyqësor (*shih vendimin nr. 9, datë 09.05.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimin në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit) (*shih vendimin nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet përmbushur, që do të thotë se individ i përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 6, datë 04.03.2010; nr. 36, datë 10.11.2010; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre.

4. Kërkuesi duhet të provojë para Gjykatës, në aspektin e shterimit të mjeteve, se nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara, apo edhe se shqyrtimi gjyqësor nuk mund t'i ndreqë këto shkelje. Në rrethana të tilla është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë, sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shteruar ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara.

5. Në kuptim të sa më sipër, në linjë edhe me qëndrimet e tjera në pakicë në çështje të së njëjtës natyrë (*shih mendimin e pakicës në vendimin nr. 35, datë 17.07.2013*), vlerësoj se kërkuesi nuk duhet të ishte legjitimuar për paraqitjen e kësaj kërkesë, në kushtet kur çështja civile e iniciuar prej tij është ende në shqyrtim në sistemin gjyqësor dhe nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata e zakonshme. Bazuar në këtë qëndrim të Gjykatës, i njëjti individ mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese disa herë brenda të njëjtit proces gjyqësor, veçmas për çdo pretendim për zvarritje të procesit gjyqësor, në çdo shkallë të tij (edhe gjatë gjykimin të çështjes në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë), dhe më pas, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar, edhe për pretendime të tjera që lidhen me të njëjtin proces gjyqësor.

6. Qëllimi i nenit 131/f të Kushtetutës, i cili përcakton rregullin e shterimit të mjeteve juridike, është që të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese. Në rastin konkret, shumica nuk ka verifikuar se cilat janë garancitë procedurale me të cilat janë të pajisura palët gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse këto mjete konsiderohen ligjore, të njohura nga ligji, të mjaftueshme, të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete dhe nëse kërkuesi i ka shteruar mjete të tilla. Në ndryshim nga shumica vlerësoj se individët gëzojnë të gjitha garancitë procedurale nga sistemi ligjor për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Pretendimet që kërkuesi ka ngritur para Gjykatës nuk janë të tilla që t'i shmangen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi pretendime të tilla mund të paraqiten lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por edhe më tej, në gjykatat më të larta, si shkaqe për ankimin dhe rekursin.

7. Për të gjitha argumentet e paraqitura më sipër vlerësoj se kërkuesi Yzeir Miraka nuk ka shteruar mjetet ligjore për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në respektim të nenit 131/f të Kushtetutës, për rrjedhojë, kërkesa e tij duhet të rrëzohej.

Anëtare: Altina Xhoxhaj



VENDIM
Nr. 57, datë 23.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare gjyqësore Blerina (Çinari) Basha, në datën 03.03.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 2 Akti, që i përket:

KËRKUES: Një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë (jo më pak se një e katërta e deputetëve), përfaqësuar në gjykim nga z. Ivi Kaso dhe z. Gazment Bardhi.

SUBJEKT I INTERESUAR: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Jonida Hoxha dhe z. Geldjon Hysolli.

OBJEKTI: Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt (jo më pak se një e katërta e deputetëve).

Deklarimi si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 36, datë 22.05.2014, të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e një komisioni hetimor për verifikimin e fakteve dhe të rrethanave të bëra publike për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët”, si shkak për lindjen e mosmarrëveshjes së kompetencës.

BAZA LIGJORE: Nenet 77, 131/ç dhe 134/1/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 54, 55 e 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, përfaqësuesit e kërkuarit, jo më pak se një e katërta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që kërkuar pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Një grup prej jo më pak se një e katërta e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, që i përket Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike (në vijim “*pakica parlamentare*”), me pretendimin se ngjarja që ndodhi në Divjakë në datën 10.05.2014, ku u rrëzua një avion që transportonte lëndë narkotike, provoi përdorimin e rregullt të infrastrukturës ushtarake për transportin e tyre, i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë me një kërkesë me objekt: “*Krijimin e Komisionit Hetimor për të verifikuar të dhënat për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët, rolin e funksionarëve publikë dhe masat e marra nga organet e pushtetit ekzekutiv përballë këtyre fakteve në vijim të informacioneve zyrtare të përcjella nga strukturat përgjegjëse.*”.

2. Qëllimi i Komisionit Hetimor ishte mbledhja e informacioneve të hollësishme mbi këtë çështje, duke evidentuar problematikat përkatëse, për të gjetur zgjidhjet për të ardhmen. Ngritja e këtij Komisioni Hetimor synonte njohjen dhe verifikimin në thellësi të fenomenit të rritjes së trafikut të drogës, me qëllim që në përputhje me realitetin të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, të plotësimit ose të korrigjimit të ligjeve të veçanta, të nxirren përgjegjësi për mënyrën e zbatimit të tij dhe të bëhen rekomandimet përkatëse për parandalimin dhe eliminimin e fenomenit kriminal, si dhe përmirësimin e gjendjes në të ardhmen.

3. Kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor pas ngjarjes së Divjakës ishte e përfshirë në rendin e ditës të seancës parlamentare të datës 22.05.2014, por pas diskutimeve mbi këtë çështje, shumica parlamentare ka vendosur: “*Mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për*



ngritjen e Komisionit Hetimor për verifikimin e fakteve dhe të rrethanave të bëra publike për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët” për faktin se objekti i punës së këtij komisioni është në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës, si dhe me interpretimet që Gjykata Kushtetuese ka bërë në vendimet e saj nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 26, datë 04.12.2006; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 12, datë 20.05.2008, nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 30, datë 16.05.2014”.

II

4. **Kërkuesi**, jo më pak se një e katërta e deputetëve, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pakicës parlamentare dhe Kuvendit të Shqipërisë, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 36/2014 të Kuvendit për arsyet e parashtruara në vijim:

4.1 Fenomeni i trafikut të lëndëve narkotike është një çështje që prek sigurinë publike dhe si e tillë paraqet interes të theksuar publik. Në këtë kuptim, kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor parlamentar respekton konceptin kushtetues “çështje e veçantë”, pasi në këtë koncept përfshihen çështje të hetimit të trajtuara në aspektin e kontrollit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të njohjes e verifikimit të një ngjarjeje a veprimtarie, që nxisin iniciativat për propozime e miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shtetin dhe shoqërinë.

4.2 Arsyetimi i Kuvendit “*se objekti i punës së këtij komisioni është në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës*” është i përgjithshëm dhe nuk jep shkaqet e vërteta për të cilat është vendosur rrëzimi i kërkesës. Objekti i hetimit jo vetëm ishte parashtruar në mënyrë të qartë, të saktë e të mjaftueshme, duke sjellë një tërësi faktesh nga të cilat merrte shkak kërkesa për kryerjen e kontrollit parlamentar, por nuk mbivendosej me punën e komisioneve hetimore të ngritura me vendimet nr. 26, datë 24.04.2014 dhe nr. 28, datë 08.05.2014 të Kuvendit të Shqipërisë.

4.3 Shumica parlamentare gjatë diskutimeve nuk ngriti asnjë pretendim në lidhje me kushtetutshmërinë e objektit të hetimit, nuk paraqiti asnjë formulim alternativ dhe as specifikoi ndonjë parim kushtetues që cenohej nga hetimi. Kuvendi në seancën parlamentare të datës 22.05.2014 nuk bëri asnjë përpjekje për të

rishikuar objektin e kërkesës për ngritjen e Komisionit Hetimor, por kërkesa iu nënshtua procedurës së zakonshme të votimit duke vendosur mospranimin me argumentet se: i) një çështje e ngjashme po hetohej nga prokuroria dhe për pasojë Kuvendi nuk mund të miratonte ngritjen e këtij Komisioni; ii) Kuvendi e kishte ngritur një komision hetimor për këtë çështje dhe, për rrjedhojë, kishte mbivendosje në objektet e hetimit.

4.4 Argumenti i shumicës parlamentare për mbivendosjen e kompetencave midis organeve kushtetuese është i pabazuar për faktin se procedura e hetimit parlamentar u shërben qëllimeve të ndryshme nga ato të hetimit penal. Ngritja e Komisionit Hetimor nuk kishte qëllim të ngrinte akuza penale ose të kërkonte lloje dhe masa dënimi ndaj personave që mund të rezultonin fajtorë. Qëllimi i Komisionit, siç pasqyrohet edhe në projektvendim, ishte të nxirrte përgjegjësitë institucionale dhe nevojën për ndryshime apo miratime ligjesh, me qëllim frenimin e fenomenit të rritjes së trafikut të drogës dhe, sipas rastit, njoftimin e prokurorisë për marrjen e masave të mëtejshme ligjore, sipas përcaktimeve të nenit 77, pika 2, të Kushtetutës.

4.5 Po ashtu, i pabazuar është edhe argumenti se kjo çështje po hetohej nga një komision hetimor tashmë i ngritur nga Kuvendi me vendimet nr. 26, datë 24.04.2014 dhe nr. 28, datë 08.05.2014 të tij. Nga krahasimi i objektit të veprimtarisë së komisionit të ngritur nga Kuvendi me atë të refuzuar rezulton një dallim thelbësor, sepse i pari shihej si një garanci për të provuar se akuzat e ngritura nga opozita janë të pabazuara, kurse i dyti nuk synonte të hetonte opozitën parlamentare, por sjelljen e organeve shtetërore kundrejt fakteve të rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët. Edhe pse pakica parlamentare ka kërkuar zyrtarisht rishikimin e objektit të hetimit në drejtim të zgjerimit të tij, me argumentin se pengonte transparencën dhe llogaridhënien e ekzekutivit, shumica parlamentare nuk i mori parasysh këto kërkesa dhe vendosi rrëzimin e tyre.

5. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka prapësuar me shkrim në mënyrë të përmbledhur si vijon:**

5.1 Pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi duke analizuar argumentet e paraqitura për



ngritjen e Komisionit Hetimor ato rezultojnë të paqarta dhe objekti nuk specifikon faktet apo kompleksitetin e tyre, por është formuluar në mënyrë të përgjithshme. Kërkuuesi nuk evidenton të dhënat konkrete dhe faktet që do t'i nënshtroheshin hetimit dhe as subjektet konkrete që do të hetohen, duke i lënë hapësirë të gjerë komisionit për të hetuar çdo funksionar publik. Mosshprehja e indicies dhe e shkakut të përligjur për argumentimin e kërkesës kushtetuese të “veçantisë” të çështjes ka sjellë shtrirjen e skajshme të rrethit të subjekteve dhe të periudhës kohore të hetimit, për rrjedhojë e ka bërë të paqartë e të papërcaktuar objektin e hetimit të Komisionit Parlamentar.

5.2 Për më tepër, Kuvendi, me vendimin nr. 26/2014, kishte ngritur një Komision Hetimor për hetimin e akuzave për përfshirjen e Forcave të Armatosura dhe të bazave ushtarake në veprimtari të kundërligjshme – transportin e lëndëve narkotike. Për rrjedhojë, të gjitha shqetësimet e kërkuësve gjenin zgjidhje me ngritjen e këtij komisioni, i cili po zhvillonte veprimtarinë e tij. Për këtë arsye, Kuvendi nuk kishte pse të ngrinte një komision të dytë hetimor me objekt të ngjashëm me atë të ngritur tashmë për çështjet e mësipërme.

5.3 Gjatë mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, si dhe gjatë zhvillimit të seancës plenare, përfaqësues të shumicës parlamentare janë shprehur qartazi në lidhje me cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve nga përmbajtja e objektit të veprimtarisë së Komisionit Hetimor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

6. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur për legjitimitimin e një grupi deputetësh në kërkesat për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve së kompetencave që kanë lindur për shkak të vendimmarrjeve të Kuvendit mbi Komisionet Hetimore (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim ajo ka çmuar se çdo organ juridiksional, qoftë institucion ose organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, apo edhe subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i

legjitimuar për të qenë palë në mosmarrëveshje pushtetesh.

7. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 77, pika 2, i Kushtetutës i njeh pakicës parlamentare kompetencë hetimi, pengimi i së cilës përbën konflikt kushtetues kompetencash. Vendimi i Kuvendit për mosmiratimin e kërkesës së një të katërtës së deputetëve për ngritjen e Komisionit Hetimor parlamentar cenon këtë të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare. Situata të tilla, në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, shkaktojnë në realitet një mosmarrëveshje ndërmjet pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve), nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, për ushtrimin e së njëjtës kompetencë kushtetuese (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 30, datë 16.05.2014 Gjykatës Kushtetuese*).

8. Për arsyet e mësipërme, kërkuuesi, jo më pak se një e katërta e deputetëve, legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet subjekteve kushtetuese të sipërcituara.

B. Për të drejtën e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor

9. Kushtetuta në nenin 77, pika 2, parashikon se Kuvendi ka të drejtë dhe me kërkesë të një të katërtës të të gjithë anëtarëve të tij është i detyruar të caktojë komision hetimor për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Në interpretimin e këtij formulimi kushtetues Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi vihet në dy pozicione të ndryshme: nga njëra anë, krijimi i komisionit hetimor paraqitet si një e drejtë e Kuvendit, gjë e cila realizohet sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë apo në Rregulloren e Kuvendit dhe që i nënshtrohet vendimmarrjes përkatëse, nga ana tjetër, dispozita kushtetuese, duke parashikuar shprehjen “është i detyruar”, jo vetëm që e vendos Kuvendin në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por njëkohësisht institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. E drejta për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor është parashikuar në



Kushtetutë si e drejtë edhe e një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit. Ngritja e komisionit me votë të një pakice, ose siç pranohet në doktrinën kushtetuese nëpërmjet zbatimit të parimit *të hetimit me votim pakice*, e forcon në mënyrë të konsiderueshme rolin e komisionit hetimor si një instrument efikas kontrolli. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se e drejta e hetimit parlamentar është zhvilluar në kuptimin e së drejtës së pakicave në parlament, që t'u japë atyre një pushtet më të fortë. E drejta e hetimit realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që parlamentarët kryejnë si përfaqësues të popullit për sqarim, ose hulumtim të hollësishëm në çështjen konkrete (*shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kjo e drejtë shërben njëkohësisht edhe si një mjet në duart e pakicës parlamentare për të ushtruar kontroll kryesisht kundrejt ekzekutivit dhe për të kërkuar vënien përpara përgjegjësisë së mbajtësve të pushtetit. Në një sistem parlamentar, duke qenë se qeveria formohet nga shumica parlamentare, e cila ka në dorë shumë mjete të tjera ligjore, e drejta e kontrollit hetimor i është njohur sidomos pakicës, që, duke i pasur të kufizuara mjetet e saj, mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues. Gjykata, gjithashtu, ka vlerësuar se Kushtetuta në nenin 77, pika 2, duke njohur të drejtën për të ngritur komisione hetimore, si e drejtë e një të katërtës së deputetëve për të vepruar në mënyrë të pavarur nga shumica parlamentare, nëpërmjet shprehjes “*është i detyruar*” ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet shumicës për të vendosur dhe së drejtës së pakicës së cilësuar (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nisur nga ky këndvështrim, Gjykata ka çmuar se e drejta e pakicës vetëm për sa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor mbetet një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës. Njëkohësisht, e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të

rasteve kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohet se preken parimet kushtetuese. Gjithsesi, e drejta e një të katërtës së deputetëve për të ushtruar hetimin parlamentar nuk mund të konsiderohet absolutisht e pakufizuar. I vetmi kufizim i saj është i lidhur me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet e sanksionuara nga Kushtetuta (*shih vendimin nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Nga ana tjetër, Gjykata bazuar në interpretimin e nenit 77 të Kushtetutës, në raport edhe me norma të tjera kushtetuese, rritet se respektimi i parimeve kushtetuese në procedurën për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare nuk cenon të drejtën e pakicës për realizimin e kësaj kompetence kushtetuese. Kuvendi, në rastet kur kërkohet ngritja e komisionit hetimor nga një e katërta e deputetëve, ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit, por t'ia nënshtrojë diskutimit parlamentar shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese në objektin e veprimtarisë së tij. Ky debat realizohet për gjetjen e një konsensusi ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit deri në arritjen e një vendimmarrjeje. Prandaj, kufizimet e lejueshme kushtetuese, që kanë të bëjnë me respektimin e parimeve të rëndësishme, fokusohen në objektin e hetimit, i cili nuk mund të reduktohet nga Kuvendi deri në atë masë sa t'ia bëjë të pamundur komisionit kryerjen e veprimtarisë. Kufizimi që mund t'i bëhet objektit të hetimit me argumentin se nuk respektohen parimet kushtetuese, nuk e bën një vendimmarrje të tillë përfundimtare dhe të pakontrollueshme nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, për arsye se do ta vendoste të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare në vlerësimin e shumicës, duke dhunuar në këtë mënyrë ushtrimin normal të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata rritet se e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor është një kompetencë kushtetuese e detyrueshme për t'u respektuar dhe nuk mund të cenohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare, me përjashtim të rasteve të mosrespektimit të parimeve kushtetuese.



C. Për kushtetutshmërinë e objektit të hetimit parlamentar

15. Gjykata ka shqyrtuar një numër çështjesh me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës midis jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit për shkak të mospranimit të kërkesave së pakicës parlamentare për ngritjen e komisioneve hetimore, në të cilat në mënyrë të vazhdueshme ka vënë në dukje se në aspektin kushtetues komisioni hetimor është një nga instrumentet e kontrollit me anë të të cilit Kuvendi ushtron dhe perfeksionon pushtetin e tij legjislativ. Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është njohja dhe verifikimi i një fenomeni, i një ngjarjeje ose i një veprimtarie, me synimin për të nxjerrë përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit, ose korrigjimit të ligjeve të veçanta, si dhe për të nxjerrë përgjegjësinë mbi mënyrën e qeverisjes (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata në referim të jurisprudencës kushtetuese rithekson se kontrolli parlamentar nuk mund të përdoret tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit. Një kompetencë e tillë nuk e transformon Kuvendin në një superorgan të pushtetit të shtetit. Bazuar në parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve, demokracia parlamentare nuk është një sistem ku parlamenti mund të ushtrojë kontroll mbi çdo vendim të institucioneve, të nisë procedura për të vendosur sanksione ndaj tyre ose të marrë vendime në emër të institucioneve që e kanë një kompetencë të tillë. Një interpretim ndryshe i kësaj kompetence kontrolli që i njihet Kuvendit do të çonte në mohimin e parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve. Prandaj Gjykata në vijim të qëndrimeve të saj të mëparshme mbi këtë çështje rithekson se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, të drejtën për një proces të rregullt ligjor, prezumimin e pafajësisë, paanshmërinë, respektimin e jetës private të individit etj. (*shih vendimet nr. 18, datë*

14.05.2003; nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 20, datë 04.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Lidhur me parimet që duhen respektuar gjatë fazave të ndryshme të realizimit të qëllimit të hetimit, në çastin e formulimit të objektit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komisionit dhe në hartimin e konkluzioneve përfundimtare të hetimit, Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi mund të ngrejë komision hetimor kur përmbushen të paktën tri kushte kryesore: 1. çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; 2. objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; 3. duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështje për të cilën është i nevojshëm hetimi (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka çmuar, gjithashtu, se objekti i hetimit, i parashtruar në mënyrë të qartë e të saktë, duhet të përmbajë fakte ose tërësi faktesh nga të cilat merr shkas hetimi parlamentar dhe shpjegon se çfarë hetohet. Veç kësaj, objekti i hetimit duhet të jetë i përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme, kusht ky që kërkohet për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, e të drejtave themelore, të parimit të ndarjes së pushteteve, si dhe të kompetencave të kufizuara që disponon një komision hetimor (*shih vendimet nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 30, datë 06.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Përveç sa më sipër, Gjykata ka theksuar se objekt i hetimit parlamentar mund të jenë vetëm ato çështje që përmbushin kriterin e veçantisë. Në vlerësimin e Gjykatës në parim “*çështje e veçantë*”, objekt i hetimit parlamentar, është një çështje me rëndësi të veçantë shtetërore/publike. Lista e këtyre çështjeve me rëndësi/interes të madh shtetëror/publik nuk mund të jetë shteruese, por duhet të përcaktohet rast pas rasti. “*Një çështje*”, që në aspektin kushtetues mund t’i nënshtrohet hetimit parlamentar, përbëhet nga fakte apo rrethana, të cilat përfshihen në objektin e veprimtarisë së Kuvendit dhe për të cilat ekziston një mosmarrëveshje. Në këtë kuptim, çështja duhet të ketë ndodhur përpara marrjes së një vendimi përkatës nga ana e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor. Për pasojë,



duhet theksuar se komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt një çështje në kuptimin kushtetues dhe jo për të verifikuar nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 20, datë 04.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*)

20. Në këtë mënyrë Gjykata, duke rikonfirmuar qëndrimin e konsoliduar mbi çështjen e veçantë, domethënë një çështje të një rëndësie të veçantë publike, rithekson se Kushtetuta nuk ndalon Kuvendin që në funksion të veprimtarisë së tij ligjvënëse të ngrejë komisione hetimore të tilla që mund të ngarkohen me hetimin e aktivitetit të shtetit ose institucioneve të qeverisjes vendore, pra për mënyrën si kryejnë institucionet përkatëse shtetërore ose vendore funksionet e tyre të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje (*shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007; nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se Kuvendi me vendimin nr. 36/2014, datë 22.05.2014 nuk ka miratuar kërkesën e një grupi deputetësh, përfaqësues të pakicës parlamentare, për ngritjen e Komisionit Hetimor për verifikimin e fakteve dhe të rrethanave të bëra publike për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët.

22. Kërkesa për ngritjen e komisionit hetimor u paraqit në Kuvend ndërkohë që zhvillonte veprimtarinë një komision hetimor tjetër, i ngritur me vendimin nr. 26, datë 24.04.2014 mbi kërkesën e një grupi deputetësh të shumicës parlamentare, që kishte për objekt hetimin e akuzave të opozitës për rritje të trafikut të drogës dhe përfshirje të FA-ve, pas publikimit të një informacioni shkresor të SHISH-it, i klasifikuar si “sekret”, drejtuar ministres së Mbrojtjes, me lëndën “*Dyshime serioze për shfrytëzimin e aerodromit të Gjadrit në funksion të transportit dhe trafikut të drogës*”.

23. Nga materialet e depozituara, Gjykata konstaton se pas paraqitjes së kërkesës për ngritjen e Komisionit Hetimor nga pakica parlamentare, Kryetari i Kuvendit e ka kaluar çështjen për shqyrtim në Konferencën e Kryetarëve të datës 16.05.2014. Nga procesverbali i mbledhjes konstatohet se

diskutimi është fokusuar në disa çështje: së pari, deputetë të shumicës kanë bërë të ditur faktin se çështja e Divjakës i është dërguar Gjykatës së Krimeve të Rënda, ndërkohë që personat e akuzuar janë arrestuar nga policia dhe për këtë arsye duhet të pritet të vendosin organet kompetente. Së dyti, kërkesa është e përsëritur për faktin se çështjet që kërkojnë të hetohen janë duke u trajtuar nga Komisioni Hetimor i ngritur me vendimin nr. 26, datë 24.04.2014 të Kuvendit, në punimet e të cilit pakica e kishte bojkotuar pjesëmarrjen. Në këtë kuptim, *çështja e veçantë*, trafiku i drogës, që ishte tashmë objekt hetimi parlamentar, nuk mund të dublohej.

24. Gjykata vëren se në përfundim të diskutimeve nuk ka pasur konsensus dhe për këtë arsye shqyrtimi i kërkesës së pakicës parlamentare i është kaluar seancës plenare të Kuvendit. Edhe gjatë shqyrtimit të kërkesës në seancën plenare parlamentare të datës 22.05.2014, vërehet se nuk u ra dakord për ngritjen e Komisionit Hetimor. Për sa u përket argumenteve të shumicës parlamentare kundër ngritjes së Komisionit Hetimor, ato përfshijnë si ekzistencën e një komisioni hetimor me të njëjtin objekt, ashtu edhe mungesën e qartësisë së objektit të hetimit (përdorimi i termave të përgjithshëm “verifikim të dhënash” dhe “rol i funksionarëve publikë”). Në përfundim të seancës plenare Kuvendi ka votuar për rrëzimin e kërkesës së pakicës parlamentare.

25. Po ashtu, Gjykata konstaton se edhe gjatë debatit të lartpërmendur, diskutimet në Konferencën e Kryetarëve dhe në seancën plenare në Kuvend nuk janë zhvilluar në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit. Edhe kur shumica parlamentare pretendon se cenohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit, ajo është e detyruar të propozojë formulime alternative duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj. Në rastin në shqyrtim, debati nuk ka pasur si orientim kryesor mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, por mohimin e saj.

26. Në lidhje me përmbajtjen e vendimit objekt kundërshtimi, Gjykata konstaton se arsyetimi i Kuvendit është tepër i përgjithshëm dhe nuk jep shkaqet për të cilat është vendosur



rrëzimi i kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor. Nga diskutimi për shqyrtimin e kësaj kërkesë në Konferencën e Kryetarëve dhe në seancën plenare në Kuvend, sikurse u parashtua në rrethanat e çështjes dhe u analizua më sipër, vërehet se arsyet kryesore të mospranimit të saj janë ekzistenca e një komisioni tjetër hetimor për të njëjtin fenomen, i ngritur nga shumica parlamentare, mbivendosja me procesin hetimor që është duke kryer ndërkohë organi i prokurorisë për të njëjtën ngjarje, duke ndërhyrë në sferën e veprimtarisë së institucioneve të tjera kushtetuese, si dhe mungesa e qartësisë së objektit të hetimit për shkak të përdorimit të termave të përgjithshëm si “verifikim të dhënash” dhe “rol i funksionarëve publikë”.

27. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se çështja që shtrohet për diskutim në rastin konkret është nëse objekti i hetimit parlamentar, i pretenduar nga pakica parlamentare, përmbush kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe, në veçanti, atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Për pasojë, identifikimi i objektit të veprimtarisë hetimore të komisionit parlamentar është parakusht për të përcaktuar nëse duhet ose jo të ndërmerret një hetim i tillë. Kjo edhe në drejtim të verifikimit nëse përbën çështje të një rëndësie të veçantë shtetërore/publike çështja objekt hetimi parlamentar.

28. Gjykata vëren se, sipas kërkesës së pakicës parlamentare, si objekt hetimi është përcaktuar *verifikimi i të dhënave për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët, rolin e funksionarëve publikë dhe masat e marra nga organet e pushtetit ekzekutiv përballë këtyre fakteve në vijim të informacioneve zyrtare të përjellta nga strukturat përgjegjëse.*

29. Kërkesa e pakicës parlamentare, sikurse u përmend më lart (*shih paragrafin 1*) mori shkas nga incidenti i Divjakës, çka e bën objektin e hetimit të Komisionit Hetimor të fokusohet në një çështje konkrete dhe që përmbush kriterin që ekziston, në fakt, një çështje, e cila ka ndodhur përpara paraqitjes së kërkesës për ngritjen e komisionit dhe, rrjedhimisht, përpara marrjes së vendimit përkatës nga ana e Kuvendit.

30. Gjykata rithekson qëndrimin lidhur me rëndësinë e çështjes së veçantë shtetërore/-publike dhe vlerëson se është kompetencë e

Kuvendit, në rastin konkret e pakicës parlamentare, të vlerësojë interesin publik për çështjet që kërkon të hetohen.

31. Sipas pakicës parlamentare, fenomeni i trafikut të lëndëve narkotike është një çështje që prek sigurinë publike, për rrjedhojë përbën çështje me interes publik dhe për këtë arsye përbën domosdoshmëri nxjerrja e përgjegjësiwe institucionale dhe marrja e masave për frenimin e fenomenit. Nga ana tjetër, nga analiza e kërkesës së pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor dhe nga mënyra e përcaktimit të objektit të saj, Gjykata vëren se ky i fundit është specifikuar në mënyrë të tillë që nuk lë vend për paqartësi apo dykuptimësi.

32. Edhe për sa i përket qëllimit të ngritjes së Komisionit Hetimor, Gjykata, në referim të standardeve kushtetuese, vlerëson se objekti përputhet me kompetencat kushtetuese të Kuvendit, pra me të drejtën e pushtetit legjislativ për t’u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga ana e Forcave të Armatosura. Po në këtë aspekt, objekti nuk përmban pasaktësi apo paqartësi të dukshme në mënyrën e formulimit të tij pasi shpjegohet harku kohor i hetimit, si dhe faktet që duhet të hetohen.

33. Përveç sa më sipër, Gjykata vlerëson të shprehet edhe në lidhje me qëndrimin kundër që ka mbajtur shumica parlamentare për ngritjen e Komisionit Hetimor për shkak se e njëjta ngjarje po hetohet nga prokuroria.

34. Gjykata rithekson se në çështje ku pretendohet mosmarrëveshja e kompetencave nga ngritja e komisioneve hetimore, një nga aspektet më të rëndësishme që shtrohet për diskutim është nëse objekti i hetimit parlamentar respekton parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, në kuptim edhe të jurisprudencës së kësaj Gjykate. Gjykata ka ritheksuar në mënyrë të vazhdueshme se ekziston një dallim thelbësor midis objektit të hetimit parlamentar dhe atij të prokurorisë, pasi natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëlllojtë dhe nuk mund të barazohet me hetimin që realizojnë në bazë të ligjit organet e tjera të pavarura apo të specializuara për kryerjen e një funksioni të tillë (*shih vendimin nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në aspektin kushtetues, komisioni hetimor është një nga instrumentet e kontrollit



me anë të të cilit Kuvendi ushtron dhe perfeksionon pushtetin e tij legjislativ. Bazuar edhe në ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, komisioni hetimor ka të drejtë të mbledhë të dhëna që mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, administron dokumente zyrtare, të dhëna të tjera, thërret dëshmitarë, thërret ekspertë, thërret titullarë institucionesh për pyetje, si dhe kërkon nga ata informacione ose dokumente zyrtare (*shih vendimet nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Duke iu kthyer rastit konkret, nisur nga qëllimi dhe objekti i Komisionit Hetimor të kërkuar, Gjykata vëren se nuk kemi të bëjmë me ndonjë përpjekje të pakicës që parlamenti të përvetësojë kompetencën e prokurorisë për të ndjekur vetë penalisht apo për të kryer vetë hetime për çështjen konkrete. Këtë mundësi pakica parlamentare e ka përjashtuar vetë në kërkesën që i ka drejtuar Kuvendit kur ka deklaruar se hetimi do të realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe do të konsistojë në nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale, duke ndihmuar evidentimin e problemeve dhe mospërsëritjen e këtij fenomeni me ndikim në sigurinë publike dhe mbrojtjen e interesit publik.

36. Po ashtu, Gjykata vlerëson se qëllimi i Komisionit nuk ka qenë hetimi mbi çështjet për të cilat ka filluar procedimi penal, por ajo që kërkohet të hetohet është çështja se sa efikase dhe të përgjegjshme kanë qenë institucionet shtetërore në kryerjen e detyrës së tyre në funksion të parandalimit të fenomenit të trafikut të lëndëve narkotike. Në këtë kuptim, në vlerësimin e Gjykatës, natyra e hetimit parlamentar, që kërkohet të kryhet, nuk është e njëlllojtë dhe nuk mund të barazohet me objektin e hetimit të organit të prokurorisë.

37. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se, përderisa pushteti i pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në dyshim, fakti se një çështje e ngjashme po hetohet nga prokuroria, nuk krijon pengesë *a priori* në ngritjen e tij. Duke rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur edhe në vendimmarrjet e mëparshme, Gjykata rithekson se është detyrë e komisionit hetimor dhe e Kuvendit që pas

ngritjes së Komisionit të përqendrohen në objektin e hetimit parlamentar, në mënyrë të tillë që të shmanget çdo ndërhyrje në veprimtarinë e organit të prokurorisë, në rastin konkret apo të organeve të tjera shtetërore nëpërmjet dublimit apo zëvendësimit të kompetencave, gjë që mund të krijonte një situatë konflikti kompetencash midis tyre.

38. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se argumenti i përdorur nga Kuvendi për mosmiratimin e kërkesës së pakicës parlamentare për ngritjen e Komisionit Hetimor në fjalë, pra se për të njëjtën ngjarje po kryhen hetime nga ana e organit të prokurorisë, është i pabazuar.

39. Bazuar në të gjitha argumentet e mësipërme, lidhur me të drejtën e pakicës parlamentare për të iniciuar një kontroll parlamentar, Gjykata rithekson se ngritja e komisionit hetimor parlamentar, kur kërkohet nga pakica parlamentare, është e detyrueshme. E drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në diskutim. Kushtetuta “... ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit” dhe, mbi këtë bazë, Kuvendi “... ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit” kur kjo kërkohet nga pakica parlamentare (*shih vendimin nr. 20, datë 04.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm pasi komisioni hetimor të jetë ngritur, nëse Kuvendi ka rezerva lidhur me respektimin e parimeve dhe standardeve kushtetuese në objektin e hetimit, duhen bërë përpjekje të përbashkëta për shmangien e tyre deri në arritjen e një vendimmarrjeje. Në të kundërt, një vendimmarrje e njëanshme e Kuvendit që kufizon apo devijon objektin e hetimit, krijon një konflikt kompetencash, i cili përbën shkak për vënien në lëvizje të kësaj Gjykate.

40. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, bazuar edhe në jurisprudencën e saj, Gjykata vlerëson se e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor në rastin konkret është mohuar nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se kërkesa e pakicës parlamentare për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave dhe shfuqizimin e vendimit të Kuvendit është e bazuar.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 77, 131, shkronja “ç”, 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës, si dhe të neneve 54, 55, 56 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- Deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 36/2014, datë 22.05.2014 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për verifikimin e fakteve dhe të rrethanave të bëra publike për fenomenin e rritjes së trafikut të drogës, përfshirë përdorimin e hapësirës ajrore nga narkotrafikantët””.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 58, datë 23.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 18.06.2015 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 22 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shkëlqim Sinani, përfaqësuar nga avokat Delo Meçani, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TE INTERESUARA: Ministria e Financave, Dega e Thesarit Vlorë, Prokuroria e Përgjithshme.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2013-2413, datë 17.02.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 1 i Protokollit nr. 1, si dhe nenet 16, 19, 20 dhe 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Financave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “Vrasje me dashje” nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, në bazë të nenit 76 të Kodit Penal, e ka dënuar atë me 13 vjet heqje lirie me vendimin nr. 122, datë 17.11.1995. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 39, datë 24.01.1996.

2. Në datën 13.03.1997, nisur nga trazirat e këtij viti, kërkuesi është larguar nga burgu i Rrogozhinës dhe është arrestuar në Treviso, Itali në datën 12.12.2006 me qëllim ekstradimin drejt vendit tonë, proces i cili ka përfunduar në datën 22.08.2007. Ky fakt rezulton nga shkresa nr. 684/1prot, datë 25.05.2009 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

3. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt: “Llogaritje e kohës së paraburgimit të vuajtur. Ndërprenje e ekzekutimit të dënimit penal, duke e



përfashtuar nga vuajtja e mëtejshme e dënimit për shkak të parashkrimit dhe shuarjes së tij”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 62, datë 15.06.2009, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke ndërprerë vuajtjen e mëtejshme të dënimit, dhe ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm të paditësit.

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi me objekt: “Kompensim për burgim të padrejtë”, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 1984, datë 21.07.2009.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 134, datë 23.02.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2013-2413, datë 17.12.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi.

II

7. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) në datën 04.02.2015 me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar në mënyrë të përmblendhur si vijon:

7.1 Është cenuar *standardi kushtetues i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi shkaqet e parashtruara në rekurs kishin të bënin me zbatimin e gabuar të ligjit material, dhe në këtë kuptim ato përfshihen në rastet e përcaktuara në nenin 472 të KPC-së.

7.2 Prokuroria, duke urdhëruar burgosjen e një personi të cilit i ishte parashkruar vendimi i dënimit me burgim, ka vepruar në kundërshtim me nenin 27 të Kushtetutës, që përcakton se askujt nuk mund t’i hiqet liria, përveç se në rastet dhe procedurat e përcaktuara në ligj.

7.3 Po ashtu, nuk është respektuar neni 44 i Kushtetutës, që parashikon të drejtën e kujt do për t’u zhdëmtuar në përputhje me ligjin në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi apo mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

8. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

8.1 Pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit dhe të aksesit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është i pabazuar, për faktin se vendimi përmban arsyet për pabazueshmërinë e pretendimeve sipas kërkesave të nenit 472 të KPC-së.

8.2 Pretendimi për cenimin e nenit 27 të Kushtetutës nuk mund të jetë pjesë e gjykimit kushtetues, sepse pavarësisht se është i bazuar, përbën një çështje *res judicata*. Kjo shkelje kushtetuese është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, me vendimin nr. 62, datë 15.06.2009, ka vendosur lirimin e menjëhershëm të kërkuesit duke e përfashtuar atë nga vuajtja e dënimit.

8.3 Po ashtu i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e nenit 44 të Kushtetutës, për faktin se arsyetimet ligjore të gjykatave të zakonshme janë vlerësuar si të bazuara nga Gjykata e Lartë.

9. **Subjekti i interesuar, Ministria e Financave**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

9.1 Pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, pasi ligji ka përfashtuar nga kompensimi personin e dënuar, edhe kur ai është deklaruar i pafajshëm, kur është provuar se vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

9.2 Ka rezultuar e provuar që kërkuesi me veprimet e tij është shmangur nga detyrimet që rridhnin nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe ka ndikuar në ekzekutimin e vendimit në një moment të mëvonshëm. Në këto kushte ai nuk mund të pretendojë kompensimin për periudhën 2006-2009.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitetin e kërkuesit

10. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individ, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2013-2413, datë 17.02.2013 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (*dhomë këshillimi*).



11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.07.2009; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata rithekson se ajo nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “F”, të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 03.06.2009; nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Bazuar në standardet e mësipërme dhe në natyrën e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata çmon se vlerësimi i tyre përfshihet *prima facie* në juridiksionin kushtetues.

A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

14. Sipas kërkuesit, ndonëse pretendimet e parashtruara në rekurs përfshihen në shkaqet e përcaktuara nga neni 472 i KPC-së, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve, duke mosrespektuar detyrimin që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është

element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur ose pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 20, datë 13.04.2012; nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, rithekson se arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 17, datë 17.05.2011; nr. 108, datë 03.10.2012; nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 51, datë 07.10.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Referuar standardeve të lartpërmendura, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit, nuk paraqet paqartësi dhe ndjek një linjë logjike në tërësinë e tij, duke parashtruar në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta, si edhe shkaqet në bazë të të cilave kërkuesi ka pretenduar ndryshimin e vendimeve gjyqësore dhe pranimin e padisë. Në këtë vështrim Gjykata vlerëson se vendimi i mospranimit të rekursit bazohet në nenin 480 të KPC-së, sipas të cilit është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në



dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e saj të vendosë mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

18. Po ashtu, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e neneve 27 dhe 44 të Kushtetutës nuk shoqërohen me argumente për cenimin e elementeve të procesit të rregullt ligjor dhe si të tilla ato përfshihen në rrethin e çështjeve që i takojnë sferës së kompetencës të gjykatave të zakonshme për interpretimin e dispozitave ligjore dhe vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët dhe jo juridiksionit kushtetues.

19. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e parashtruara nga kërkuari për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “F”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Vitore Tusha

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky vendim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Nga rrethanat e çështjes konstatohet se kërkuari pas ekstradimit nga Italia në gusht të

vitit 2007 ka vazhduar vuajtjen e dënimit me burgim deri në qershor të vitit 2009. Ndërkohë që ai ishte duke vuajtur dënimin i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesëpadi për ndërprerjen e vuajtjes së mëtejshme të dënimit me pretendimin se sipas përcaktimeve të nenit 68, pika “b”, të KPP-së vendimi i dënimit nuk mund të ekzekutohej, pasi jo vetëm se nga dita që ai kishte marrë formë të prerë kishin kaluar dhjetë vjet, por masa e dënimit me 13 vjet përfshihej në kufirin e përcaktuar nga KPP-ja “dënim nga 5-15 vjet burgim”.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka pranuar kërkesën dhe e ka liruar kërkuarin nga vuajtja e mëtejshme e dënimit me arsyetimin se nga data 24.01.1996, që vendimi i dënimit me 13 vjet burgim ka marrë formë të prerë, deri në datën 12.12.2006, që kërkuari është arrestuar në Itali, kanë kaluar më tepër se 10 vjet.

4. Më pas kërkuari i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për t’u kompensuar për burgim të padrejtë për 945 ditë kalendarike (nga 12.12.2006 deri në 15.06.2009). Gjykata, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesëpadinë, ka arritur në përfundimin se kërkuari nuk përfshihet në rastet e parashikuara nga nenet 2 dhe 3 të ligjit nr. 9381, datë 28.04.2005 “Për kompensimin e burgimit të padrejtë”. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, kurse Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi me arsyetimin se rekursi nuk përmbush asnjë nga rastet e nenit 472 të KPC-së, ndërkohë që në pjesën hyrëse të vendimit rendit si pretendime të kërkuarit zbatimin e gabuar të përcaktimeve të nenit 68/b të KPP-së dhe nenit 69 të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dëbuarve me burgim”, si dhe mosrespektimin e nenit 27 të Kushtetutës.

5. Kërkuari në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese ka pretenduar, midis të tjerash, cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor me argumentin se ndonëse pretendimet e parashtruara në rekurs përfshihen në shkaqet e përcaktuara nga neni 472 i KPC-së, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve duke mos respektuar detyrimin që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës për arsyetimin e vendimeve gjyqësore.



6. Shumica e ka trajtuar pretendimin ashtu siç është parashtruar nga kërkuesi, duke arritur në përfundimin se nuk ka cenim të këtij standardi. Megjithatë, në referim të jurisprudencës kushtetuese dhe veçanërisht parimit *iura novit curia* shumica kishte mundësinë ta vlerësonte vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë binin në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj, dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi. Në rastin konkret, nisur nga faktet e pretenduara nga kërkuesi, mendojmë se shumica duhet t'i vlerësonte ato nën dritën e të drejtës së kërkuesit për të pasur akses në Gjykatën e Lartë.

7. Në rastin konkret vlerësojmë se shtrohen për diskutim disa aspekte të vendimmarrjes së shumicës: *së pari*, nëse ajo i ka dhënë kuptimin e duhur aksesit substancial të kërkuesit, *së dyti*, nëse e ka vlerësuar drejt rolin që i takon Gjykatës së Lartë në vlerësimin e aspekteve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe, *së fundi* nëse vetë shumica, pra Gjykata Kushtetuese, i ka përmbushur efektivisht detyrimet që burojnë nga parimi i subsidiaritetit.

8. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore vërejmë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ajo e Apelit Vlorë e analizojnë nenin 2 të ligjit nr. 9381/2005 “Për kompensim të burgimit të padrejtë” në mënyrë sipërfaqësore dhe deklarative, pasi ato vetëm pasqyrojnë kategoritë e personave që kanë të drejtë të përfitojnë kompensim për burgim të padrejtë. Për sa i takon interpretimit të nenit 3, ai mungon tërësisht. Për më tepër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë arsyeton se “... shuarja dhe parashkrimi i ekzekutimit të vendimit penal ka ardhur si rezultat i veprimeve me dashje të paditësit dhe tërësisht të qëllimshme të tij për mosëkzekutim të vendimit penal dhe jo për shkaqe ligjore si pafajësi ose pushim të çështjes me vendim të formës së prerë të gjykatës ose prokurorisë, prandaj padia duhet të rrëzohet si e pambështetur në ligj...”.

9. Nëse arsyetimin e mësipërm e vlerësojmë nën dritën e vendimit unifikues nr. 7, datë 11.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbi nenin 68 të KP-së (parashkrimi i dënimit), konstatohet një qëndrim i ndryshëm i tyre në lidhje me qëndrimin që duhet të mbahet ndaj të dënuarve, të cilët kanë vuajtur vetëm një pjesë të dënimit pasi janë larguar nga burgu.

Konkretisht, KBGJL-të arsyetojnë se “... vetëm fakti që i dënuari ka vuajtur vetëm një pjesë të dënimit nuk mund ta vendosë atë në pozita më të disfavorshme në raport me çdo të dënuar tjetër, vendimi penal ndaj të cilit nuk është vënë ende në ekzekutim. Ishte detyra e organeve shtetërore, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve penale, që të merrnin masat e duhura për të gjetur dhe kapur këtë të dënuar dhe për ta detyruar atë të vazhonte vuajtjen e mëtejshme të dënimit. Për këtë kategori të dënuarish duhet të zbatohet i njëjti rregull. Nisur nga parimi i barazisë para ligjit instituti i parashkrimit të dënimit duhet të zbatohet njëjloj për të gjithë të dënuarit, si për ata ndaj të cilëve ekzekutimi nuk ka filluar edhe për ata ndaj të cilëve nuk është përmbushur plotësisht. Është e padrejtë që të përfitojë një person që nuk ka vuajtur asnjë ditë burg dhe të mos përfitojë një person që ka vuajtur një pjesë të dënimit...”.

10. Përveç sa më sipër, KBGJL-të kanë unifikuar praktikën edhe për sa i takon kuptimit të kompensimit të padrejtë me vendimin unifikues nr. 3/2003 ku arsyetojnë se “... në të gjitha rastet e kërkesave për kompensim për burgim të padrejtë ndodhemi para vendimeve të gabuara të organit procedues (gjykatës, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore), por, personit që është dëmtuar nga ky vendim duke u burgosur padrejtësisht, i lind e drejta për t'u kompensuar për këtë burgim vetëm në qoftë se ai nuk ka vepruar me faj (dashje ose pakujdesi të rëndë) në dhënien e vendimit të fajësisë në dëm të tij. Përfundimin nëse kërkuesi ka qenë ose jo me faj në raport me vendimin e burgimit të padrejtë gjykata që shqyrton kërkesën për kompensim për burgim të padrejtë paraqitur prej tij e arrin duke u nisur rast pas rasti, nga tërësia e vendimit mbi bazën e të cilit ai u burgos (apo edhe u paraburgos) dhe sidomos, nga pjesa arsyetuese e tij, në të cilën gjykatat, sipas kërkesave të KPP-së, janë të detyruara të parashtrorjnë në mënyrë sa më të hollësishme, të qartë e bindëse, si provat e fajësisë, ashtu edhe të pafajësisë dhe të pasqyrojnë qëndrimin e të pandehurit në raport me to e në përgjithësi me akuzën në ngarkim të tij, si dhe në raport me tërësinë e rrethanave të çështjes që përbëjnë objektin e të provuarit në gjykimin e çdo çështjeje penale (çfarë ka ndodhur, ku ka ndodhur, kur ka ndodhur, me ç'mjet ka ndodhur, si ka ndodhur, kush dhe pse e ka kryer atë)”.

11. Duke krahasuar interpretimin e dispozitave ligjore nga gjykatat e të dyja shkallëve të para me praktikën unifikuese të KBGJL-së dukshëm vihen re ndryshime në lidhje me trajtimin që ato (gjykatat) i ka bërë kërkuesit, si subjekt përfitues nga parashkrimi i ekzekutimit të



dënimit sipas nenit 68 të KP-së. Gjykata e Lartë, në praktikën e saj interpretuese e ka vënë theksin në kufizimin kohor që gjen zbatim ndaj organeve kompetente shtetërore të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, duke e cilësuar atë si një ndalim të shprehur që nuk u lejon atyre të vënë në ekzekutim vendime penale tej afateve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 68 të KP-së.

12. Nisur nga ky konstatim mendojmë se standardi i mbajtur nga Gjykata e Lartë në çështjen konkrete është i ndryshëm nga ai i praktikës gjyqësore në çështje të ngjashme. Në këtë kuptim vlerësojmë se pavarësisht se kërkuesi ka ngritur në rekurs çështje që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit, përsëri Kolegji Civil ka vendosur mospranimin në dhomë këshillimi, duke cenuar të drejtën për akses substancial të kërkuesit, si një aspekt thelbësor i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky përfundim na çon edhe në vlerësimin tjetër për sa i takon mospërmbyshjes efektivisht nga ana e Gjykatës së Lartë të funksionit si gjykatë ligji dhe garantuese e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e dy shkallëve të para.

13. Po ashtu shumica ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për cenimin e neneve 27 dhe 44 të Kushtetutës nuk shoqërohen me argumente për cenimin e elementeve të procesit të rregullt ligjor dhe si të tilla ato përfshihen në rrethin e çështjeve që i takojnë sferës së kompetencës të gjykatave të zakonshme për interpretimin e dispozitave ligjore dhe vlerësimin juridik të rrethanave e provave të parashtruara nga palët dhe jo juridiksionit kushtetues.

14. Kushtetuta në nenin 27/1 parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria përveç se në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj. Kurse neni 44 përcakton se kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore. Cilësimi nga ana e shumicës të pretendimeve të kërkuesit si të natyrës ligjore është jo i saktë, për faktin se ato duhen vlerësuar jo si pretendime të veçuara, por si argumente në funksion të pretendimit për cenimin e së drejtës për akses në Gjykatën e Lartë.

15. Gjykata Kushtetuese ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131, shkronja “f” të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në vështrim të sa më sipër, vlerësojmë se nisur nga qëndrimi i jurisprudencës kushtetuese problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete përbëjnë juridiksion kushtetues nëse ato shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave, pretendimet e kërkuesit mbi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë ishin të bazuara. Për rrjedhojë, shumica duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të ishte shfuqizuar me qëllim garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha

VENDIM Nr. 59, datë 23.7.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese			
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“



me sekretare Edmira Babaj, në datën 21.04.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 13 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Iva Xhani, Vjola Ramkaj (Xhani)

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Eleni Vrana (Xhani), Janulla Shameti (Xhani), Andon Xhani, Anduela Qerama (Xhani), Androniqi Xhani

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr. 00-2014-2166, datë 24.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura me shkrim nga kërkueset Iva Xhani dhe Vjola Ramkaj (Xhani), të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës dhe prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara Eleni Vrana (Xhani), Janulla Shameti (Xhani), të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet e çështjes në shqyrtim rezulton se në datën 25.12.2008 ka vdekur trashëgimlënësi Koço Xhani, i cili ka disponuar pasurinë e tij me testamentin nr. 43 prog, datë 26.06.2008. Testatori Koço Xhani ka caktuar si trashëgimtarë testamentarë Andon Xhanin, Eleni Vranën (Xhani), Janulla Shametin (Xhani) (subjektet e interesuara në gjykimin kushtetues), Elda Priftin, Ledio Shametin, Thanas Shametin, Zhuljeta Xhanin, Anduela Qeramën (Xhani), Vjola Xhanin dhe Iva Xhanin (kërkueset në gjykimin kushtetues) duke disponuar për secilin pasurinë që u kalon në trashëgim. Pasuria e

disponuar përbëhet nga një apartament banimi, një ndërtesë dykatëshe lokal-restorant (me kufij të përcaktuar) dhe një magazinë, të ndodhura në qytetin e Tiranës, si dhe prej depozitës në shumën 300 000 euro.

2. Subjektet e interesuara Eleni Vrana (Xhani), Janulla Shameti (Xhani), me pretendimin se me testamentin është shkelur rezerva ligjore, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit”, duke paditur kërkueset Iva Xhani, Vjola Xhani dhe personat e tjerë përfitues sipas testamentit Andon Xhani, Anduela Xhani, Androniqi Xhani (bashkëshortja e trashëgimlënësit, e cila ka qenë në mungesë).

3. Në këtë gjykim kërkueset Iva Xhani, Vjola Xhani, Andon Xhani dhe Anduela (Qerama) Xhani kanë kërkuar me kundërpadi çeljen e dëshmisë testamentare të trashëgimlënësit Koço Xhani, detyrimin e paditësve të kundërpaditur që të njohin si të vetmit trashëgimtarë testamentarë, të paditurit kundërpaditës dhe njëkohësisht të dorëzojnë pasurinë trashëgimore të fituar prej saj.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2503, datë 01.04.2011, ka vendosur: “Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Vërtetimin e pavlefshmërisë së pjesshme të testamentit nr. 43 prog, datë 26.06.2008 të testatorit Koço Xhani vetëm në pjesën që testatori cenon vullnetin e trashëgimtarëve për disponimin e pasurive të kaluara me këtë testament dhe konkretisht në pjesën që detyron trashëgimtarin Janulla Shameti që me dëshirën e saj të mund t’u lërë dy djemve të saj apartamentin e banimit në rrugën “Stavri Themeli” dhe ndalon trashëgimtarët Anduela Qerama (Xhani), Vjola Ramka (Xhani) dhe Iva Xhani që të mos disponojnë për 30 vjet pasuritë e lëna në trashëgimi, që janë restorant “Durrësi”, lokali (ndërtesa dykatëshe) i ndodhur në rrugën “Qemal Stafa” dhe magazina e ndodhur në rrugën “Mustafa Matohiti”. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesët e tjera. Pranimin e pjesshëm të kundërpadisë. Njohjen e Andon Xhanit, Eleni Vranës (Xhani), Janulla Shametit (Xhani), Elda Priftit, Ledio Shametit, Thanas Shametit, Zhuljeta Xhanit, Anduela Qeramës (Xhani), Vjola Xhanit dhe Iva Xhanit si trashëgimtarë të trashëgimlënësit Koço Xhani, të



cilët trashëgojnë respektivisht pasuritë e përcaktuara në testamentin nr. 43 prog, datë 26.06.2008. Detyrimin e paditësve të kundërpaditur Eleni Vrana dhe Janulla Shameti që t'u dorëzojnë të paditurve kundërpaditës Andon Xhani, Anduela Qerama (Xhani), Iva Xhani, Vjola Ramka (Xhani) pasuritë e përcaktuara për to në testamentin nr. 43 prog, datë 26.06.2008 dhe frytet civile të fituara prej tyre. Rrëzimin e kundërpadisë për pjesët e tjera.

5. Mbi ankimin e subjekteve të interesuara Eleni Vrana (Xhani) dhe Janulla Shameti (Xhani), Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2269, datë 02.11.2011, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar kërkesëpadinë. Shpalljen si të pavlefshëm të testamentit të lënë nga trashëgimlënësi Koço Xhani me nr. progresiv 43, datë 26.06.2008, si dhe të procesverbalit përkatës të kalimit të testamentit në regjistrin e përgjithshëm të noteres V.S. rrëzimin e kundërpadisë.

6. Mbi rekursin e subjekteve të interesuara Eleni Vrana (Xhani) dhe Janulla Shameti (Xhani), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2014-2166, datë 24.07.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

7. **Kërkueset Iva Xhani dhe Vjola Ramkaj (Xhani)** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke argumentuar:

7.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 407 të Kodit Civil (rezerva ligjore). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos i dhënë përgjigje këtij pretendimi ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

7.2 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka zhvilluar procesin pa thirrur në gjykim një nga trashëgimtarët e Koço Xhanit, Zhuljeta Xhanin duke cenuar parimin e kontradiktoritetit. Gjykata e Lartë duhet ta konstatonte këtë shkelje procedurale.

7.3 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2014-2166, datë 24.07.2014, ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor pasi nuk ka pasqyruar shkaqet e ngritura në rekurs. Gjithashtu, ky kolegji nuk ka

argumentuar arsyet e mospranimit të rekursit ndonëse shkaqet e ngritura në rekurs janë të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. Në kushtet kur dy gjykatat më të ulëta kanë mbajtur qëndrime të kundërta, Gjykata e Lartë si gjykatë ligji duhet të ishte shprehur lidhur me pretendimet e parashtruara në rekurs.

8. **Subjektet e interesuara Janulla Shameti dhe Eleni Vrana (Xhani)** paraqitën parashtrime me shkrim si vijojnë:

8.1 E drejta e aksesit nuk është cenuar pasi kërkueset gjatë gjykimit kanë shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike dhe hapësirat ligjore për mbrojtjen e pretendimeve të tyre. E drejta e aksesit ka qenë e garantuar dhe është respektuar nga të tria gjykatat.

8.2 Lidhur me pretendimin e cenimit të së drejtës së kontradiktoritetit, pasi në gjykim nuk është thirrur njëra prej trashëgimtareve, konkretisht Zhuljeta Xhani. Kërkueset nuk e kanë ngritur këtë pretendim as në gjykimin në Gjykatën e Rrethit Tiranë, as në Gjykatën e Apelit Tiranë. Zhuljeta Xhani ka qenë në dijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor.

8.3 Pretendimi për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) është i pabazuar. Ky kolegji, pasi ka vlerësuar shkaqet e parashtruara në rekurs, ka arsyetuar se nuk janë shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile dhe duke respektuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor ka vendosur mospranimin e rekursit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueseve

9. Gjykata Kushtetuese (në vijim Gjykata) vlerëson të analizojë fillimisht legjitimitimin e kërkueseve në paraqitjen e kësaj kërkeje. Në nenet 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, përcaktohet e drejta e individit për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

10. Gjykata Kushtetuese konstaton se në rastin konkret kërkueset legjitimohen *ratione*



temporis, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2 vjeçar të përcaktuar në nenin 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Kërkueset kanë pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duke interpretuar në mënyrë të gabuar dispozitën ligjore mbi rezervën ligjore kanë cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë.

12. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka theksuar se kontrolli kushtetues që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, çka përbën edhe juridiksionin e saj kushtetues, në kuptim të nenit 42 dhe nenit 131, shkronja “P” të Kushtetutës. Çështja e interpretimit të ligjit nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese.

13. Për sa më sipër, për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkueset nuk legjitimohen *ratione materiae* për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

14. Gjithashtu, kërkueset kanë pretenduar se është cenuar parimi i kontradiktoritetit, pasi nuk është thirrur në gjykim një nga trashëgimtarët e Koço Xhanit, Zhuljeta Xhani.

15. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë veprimtarinë e saj, legjitimiteti i individit përbën një nga parakushtet procedurale për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë. Individi, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Individi mund të drejtohet me kërkesë në këtë gjykatë për çështje kur në bazë të normave procedurale, ai ka qenë palë drejtpërdrejt në proces. Kriteri kushtetues i “detyrimit për të justifikuar interesin”, i përcaktuar në pikën 2, të nenit 134, të Kushtetutës, është interpretuar nga jurisprudenca kushtetuese si përcaktues i ndarjes së rrethit të subjekteve kushtetuese në dy kategori, subjekte të kushtëzuara dhe subjekte të pakushtëzuara. Në këtë kuptim, kërkuesi, si subjekt i kushtëzuar, i parashikuar në shkronjën “g”, të paragrafit 1, të nenit 134, të Kushtetutës,

mund të bëjë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij.

16. Në çështjen në shqyrtim nuk rezulton se Zhuljeta Xhani ka qenë palë në gjykimet e zhvilluara në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe as kërkuese në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

17. Në këto kushte, bazuar te nenet 131/f, 134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës, kërkueset nuk legjitimohen *ratione personae* për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese lidhur me këtë pretendim.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

18. Gjykata vlerëson se kërkueset legjitimohen *ratione materiae* t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

19. Kërkueset kanë pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) në vendimin nr. 00-2014-2166, datë 24.07.2014, duke mos pasqyruar shkaqet e parashtruara në rekurs ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Kolegji nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve lidhur me shkaqet e parashtruara në rekurs, megjithëse janë të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

20. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 23.01.2014, nr. 3, datë 19.02.2013, nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referencat në



ligjin e zbatueshëm dhe respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Bazuar në parashikimet e normave procedurale, që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsytimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 36, datë 25.07.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në nenin 310, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile (KPC) parashikohet se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar në paragrafët e tjerë elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa, për gjykimin në Gjykatën e Lartë, neni 475, pika “ç” e KPC-së sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet, dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese qëndron në vlerësimin të këtyre shkaqeve. Në nenin 480 të KPC-së parashikohet se nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit.

24. Gjykata vëren se në çështjen konkrete vendimi nr. 00-2014-2166, datë 24.07.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit përmban në pjesën e tij hyrëse palët ndërgjyqëse, objektin e padisë dhe të kundërpadiës, si dhe disponimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të

Gjykatës së Apelit Tiranë. Në vendim janë parashtruar shkaqet e rekursit, në bazë të të cilave kërkueset kanë pretenduar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

25. Pretendimet e kërkueseve të parashtruara në rekurs kanë të bëjnë me interpretimin e gabuar të dispozitave të Kodit Civil, që rregullojnë kalimin e trashëgimisë me testament, rezervën ligjore, kuptimin e personave të paaftë për punë dhe të trashëgimtarit të paaftë. Kërkueset kanë pretenduar se vendimi i Gjykatës së Apelit ka shkelje të rënda procedurale, pasi janë cenuar të drejta që përfitonin nga disponimet testamentare, personat që nuk janë thirrur në gjykim, si: Elda Prifti, Ledio Shamenti, Thanas Shamenti, Zhuljeta Xhani dhe Lefter Duni. Gjithashtu, sipas tyre, gjykatat kanë gabuar në përcaktimin e radhës së thirrjes në trashëgim të personave të paaftë për punë.

26. Nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) konstatohet se në pjesën arsyetuese ai ka pasqyruar vetëm përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së duke vendosur në pjesën urdhëruese mospranimin e tij.

27. Gjykata konstaton se në çështjen në shqyrtim, pavarësisht se në vendim janë paraqitur shkaqet e parashtruara në rekurs për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Kolegji nuk ka argumentuar përfundimin e shprehur në dispozitiv për mospranimin e rekursit.

28. Bazuar në nenin 480 të KPC-së është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë në pajtim me kërkesat ligjore mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

29. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të



procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit në dhomën e këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 36, datë 25.07.2013, nr. 22, datë 06.06.2011, nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata vlerëson se nisur nga natyra e pretendimeve të parashtruara në rekurs, që lidhen me vlefshmërinë e testamentit, me formimin e ndërgjyqësisë (mosthirrja në gjykim e të gjithë trashëgimtarëve), rezervën ligjore, si dhe qëndrimin e ndryshëm të gjykatave të faktit për këto çështje, Gjykata e Lartë ishte e detyruar të arsyetonte qëndrimin e saj, pasi në thelb këto pretendime kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së pronësisë dhe cenimin e pritshmërisë së ligjshme, që rrjedhin nga trashëgimia testamentare. Mungesa e arsyetimit në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) përbën një mangësi në përmbajtjen e vendimit të kësaj gjykate.

31. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka cenuar parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe se pretendimi i kërkueseve është i bazuar.

32. Në përfundim, për sa kohë kërkuaset nuk kanë marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë për pretendimet kushtetuese të parashtruara në rekurs, atyre u është mohuar edhe e drejta e aksesit në kuptimin substancial në atë gjykatë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P”, dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-2166, datë 24.07.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në çështjen me kërkuas Iva Xhani dhe Viola Ramkaj (Xhani), si dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

2. Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka theksuar jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit në dhomën e këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*prg. 29 i vendimit*). Ajo ka vlerësuar më tej se nisur nga natyra e pretendimeve të parashtruara në rekurs, që lidhen me vlefshmërinë e testamentit, me formimin e ndërgjyqësisë (mosthirrja në gjykim e të gjithë trashëgimtarëve), rezervën ligjore, si dhe qëndrimin e ndryshëm të gjykatave të faktit për këto çështje, Gjykata e Lartë ishte e detyruar të arsyetonte qëndrimin e saj, pasi në thelb këto pretendime kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës së pronësisë dhe cenimin e pritshmërisë së ligjshme, që rrjedhin nga trashëgimia testamentare. Mungesa e arsyetimit në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) përbën një mangësi në përmbajtjen e vendimit të kësaj gjykate (*prg. 30 i vendimit*).

3. Nuk pajtohem me këtë përfundim të shumicës, pasi në vlerësimin tim Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje kërkuases në vendimin e saj të marrë në dhomë këshillimi. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas së



cilës arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 108, datë 03.10.2012; nr. 17, datë 17.05.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe GJEDNJ-ja ka pranuar se kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 07.12.2010, § 51*).

4. Siç jam shprehur me mendim pakice në vendimet nr. 4, datë 05.02.2014 dhe nr. 3, datë 23.01.2014, vlerësoj se standardi mbi të cilin mbështetet shumica në këtë çështje nuk krijon garanci për ruajtjen e vlerave të uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës dhe, për pasojë, lë hapësirë për cenimin e sigurisë juridike dhe të barazisë përpara ligjit. Këtë vlerësim e mbështes në arsyet që vijojnë.

5. Nga arsyetimi i shumicës nënkuptohet se në rastin e ngritjes në rekurs të pretendimeve me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, kur nuk e pranon rekursin, duhet t’u japë përgjigje këtyre pretendimeve. Në një arsyetim *a contrario*, bazuar në qëndrimin e mësipërm, nëse në rekurs nuk ngrihen pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë nuk është e detyruar t’u japë përgjigje, pasi në këto raste është i mjaftueshëm një arsyetim i kufizuar, që e përmbush standardin kushtetues të arsyetimit. Ky lloj diferencimi në trajtimin e arsyetimit, i lidhur me natyrën e

pretendimeve të ngritura në rekurs, është bërë nga shumica pa parashtruar motivet përse arsyetimi i kufizuar konsiderohet i rregullt në aspektin kushtetues në disa raste, dhe i parregullt në raste të tjera.

6. Me qëndrimin e saj shumica ka lënë shteg për një lloj ndërhyrjeje të Gjykatës Kushtetuese në rolin vlerësues të Gjykatës së Lartë. Kështu shumica, në rastin konkret, ka vlerësuar përmbajtjen e rekursit, konkretisht duke identifikuar natyrën kushtetuese të pretendimeve të ngritura në të dhe duke i imponuar Gjykatës së Lartë argumentimin në lidhje me këto pretendime. Vlerësimi i rekursit është atribut i Gjykatës së Lartë, e cila vlerëson pretendimet e ngritura në rekurs në dhomë këshillimi. Vlerësimi i procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në këndvështrim të respektimit të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të bëhet nga Gjykata, gjithmonë brenda kuadrit të kompetencave të saj, çka përjashton vlerësimin e përmbajtjes së rekursit dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të ndjekur mënyra të ndryshme për vlerësimin e pretendimeve.

7. Gjithashtu, me qëndrimin e saj, shumica krijon paqartësi për sa i përket mundësisë që ka kërkuesi për ta goditur për antikushtetutshmëri të njëjtin vendim pas rigjykimit në Gjykatën e Lartë. Në rastin konkret shumica i është shmangur vlerësimit kushtetues të pretendimeve që në çmuarjen e saj kanë natyrë kushtetuese, duke e rikthyer çështjen në Gjykatën e Lartë. Për pasojë, qëndrimi i shumicës nuk i shërben efektivitetit të shqyrtimit kushtetues dhe respektimit të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

8. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmoj se në rastin konkret nuk është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe as e drejta e aksesit në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj kërkesa e paraqitur nga kërkuësja duhet të ishte rrëzuar.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

1. Lidhur me përfundimin e arritur për çështjen me kërkuese Iva Xhanin dhe Vjola Ramkajn (Xhani) nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, prandaj e çmoj të shprehem me mendim pakice.



2. Nëpërmjet arsyetimit të saj shumica ka konkluduar se duke mos marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese, kërkueseve u është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

3. Nuk pajtohem me këtë përfundim të arritur, sepse, në vlerësimin tim, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje kërkueseve në vendimin e saj të marrë në dhomë këshillimi. Ky qëndrim mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës, sipas së cilës arsyetimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, pas shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*sibih vendimet nr. 34, datë 12.07.2013; nr. 108, datë 03.10.2012; nr. 17, datë 17.05.2011, të Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimin nr. 143, datë 07.12.2011, të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

4. Edhe GJEDNJ-ja ka theksuar se “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsyetimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 07.12.2010, § 51*).

5. Gjithashtu, kërkueset pretendimin e arsyetimit të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) nuk e kanë lidhur me shkeljen e një prej elementeve të procesit të rregullt ligjor, si barazi e armëve, kontradiktoriteti apo aksesit në gjykatë.

6. Si përfundim, për sa më lart, ndryshe nga shumica, çmoj se kërkueseve nuk u është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ndaj dhe kërkesa e tyre duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Fatmir Hoxha

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 420 lekë

